

VENDIM
Nr. 252, datë 20.4.2023

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR DECENTRALIZIMIN
DHE QEVERISJEN VENDORE 2023–2030, TË PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT
2023–2025 E TË PASAPORTËS SË INDIKATORËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030, të planit të saj të veprimit 2023–2025 dhe të pasaportës së indikatorëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, ministritë e linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera përgjegjëse, të përcaktuara në strategjinë dhe në planin e veprimit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE PËR DECENTRALIZIMIN DHE QEVERISJEN
VENDORE, 2023–2030**

Falënderime

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030 është një dokument i hartuar nga Ministria e Brendshme, nën kujdesin e ministrit të Brendshëm, z. Bledar Çuçi, dhe drejtuesit të Grupit Politik për hartimin e kësaj strategjie, zëvendësministrit të Brendshëm, znj. Romina Kuko.

Grupi teknik i hartimit të strategjisë u kryesua nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, z. Enea Hoti, sot Sekretar i Përgjithshëm, si edhe dy strukturat teknike të Ministrisë së Brendshme, ekipi i Drejtorisë së Politikave për Çështjet Vendore dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Ky dokument nuk do të ishte finalizuar pa kontributin e drejtpërdrejtë të bashkive, të ministrive të linjës dhe agjencive shtetërore, përmes një procesi të gjerë konsultimi dhe vlerësimi të gjetjeve, për të siguruar informimin dhe orientimin e nevojshëm të punës për periudhën e ardhshme 2023–2030.

Hartimi i kësaj strategjie u krye nëpërmjet një procesi të hapur, duke përfshirë kontributin dhe dijen e grumbulluar të shoqatave të vetëqeverisjes vendore, të partnerëve të zhvillimit dhe organizatave të shoqërisë civile. Falënderime shkojnë për Shoqatën për Autonomi Vendore dhe Shoqatën e Këshillave të Qarqeve. OECD/SIGMA mbështeti procesin e hartimit të strategjisë me orientime dhe komente të vlefshme qofshin në aspektin metodologjik, ashtu edhe në atë përmbajtësor. Një kontribut dhe mbështetje e rëndësishme në këtë proces është dhënë nga PNUD-i, Delegacioni Evropian, Qeveria Zvicerane, Qeveria Suedeze dhe USAID-i. Gjithashtu kontribut i vyer për procesin është dhënë nga përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë civile, të cilët ndanë dijen dhe perspektivën e tyre për agjendën e decentralizimit.

Tabela e përmbajtjes

Falënderime

Lista e shkurtimeve

Përmbledhje ekzekutive

Fusha dhe rëndësia e dokumentit

Kuadri strategjik

Parimet, metodologjia dhe struktura

Parimet

Metodologjia

Struktura

Kapitulli 1. Konteksti, arritjet dhe sfidat

Konteksti dhe arritjet

Sfidat

Kapitulli 2. Mësimet e nxjerra

Kapitulli 3. Strategjia e re Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023–2030

Vizioni

Ndërlidhjet me agjendat e integritit evropian dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm

Integrimi evropian

Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm

Qëllimet politike

Qëllimi politik 1 – Nxitja dhe forcimi i zhvillimit të qëndrueshëm vendor

Qëllimi politik 2 – Përmirësimi i cilësisë, i standardeve dhe i ofrimit të shërbimeve vendore

Qëllimi politik 3 – Zgjerimi i qeverisjes digjitale në nivel vendor për të ofruar shërbime dhe programe qeveritare në mënyrë më eficiente, transparente dhe me kosto efektive

Qëllimi politik 4 – Rritja e autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta

Qëllimi politik 5 – Forcimi i demokracisë vendore dhe përparimi i agjendës së integritit evropian në nivel vendor

Qëllimi politik 6 – Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të nevojshme vendore dhe qendrore dhe i një koordinimi e qeverisjeje funksionale gjithëpërfshirëse të aktorëve të decentralizimit

Kapitulli 4. Llogaridhënia, monitorimi dhe raportimi

Kapitulli 5. Burimet financiare për zbatimin e Strategjisë

Shtojca

Shtojca 1. Plani i veprimit

Shtojca 2. Pasaporta e indikatorëve

Lista e shkurtimeve

AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMVV	Agjencia për Mbështetje e Vetëqeverisjes Vendore
ASP	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi Evropian
DAP	Departamenti i Administratës Publike

EAMIS	Sistemi i Informacionit të Asistencës së Jashtme
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
GVV	Grupet vendore të veprimit
KK	Këshilli Konsultativ
INSTAT	Instituti i Statistikës
IPSIS	Sistemi i Informacionit të Sistemit të Planifikimit të Integruar
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MZSH	Mbrojtje nga Zjarri dhe Shpëtimin
NE	Ndihma ekonomike
NJA	Njësi administrative
NJVV	Njësitë e vetëqeverisjes vendore
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OZHQ	Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm
PAK	Pagesa për aftësinë e kufizuar
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Produkti i brendshëm bruto
PNUD	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
RAT	Reforma Administrative Territoriale
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
SIFQ	Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë
SIGMA	Mbështetja për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim
SIMF	Sistemi Informacionit për Menaxhimin Financiar
SKZHIE	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian
SNDQV	Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore
SQDNE	Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik
SHA	Shoqëri anonime
UK	Ujësjellës-kanalizime
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

Përmbledhje ekzekutive

Fusha dhe rëndësia e dokumentit

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SNDQV) 2023–2030 është dokumenti që siguron drejtimet dhe përcakton përparësitë për konsolidimin e procesit të decentralizimit dhe forcimin e fuqizimit të qeverisjes vendore në Shqipëri nën kuadrin e përgjithshëm të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030, bazuar në parimet e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore, dhe e orientuar nga agjenda e integritetit të vendit në Bashkimin Evropian e objektivat globalë të zhvillimit të qëndrueshëm.

Kuadri strategjik

Duke qenë në nivelin më pranë qytetarëve në shërbim të komunitetit, qeverisja vendore përfaqëson një nga themelet për zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë dhe përfaqësimin sa më të mirë të interesave të tyre. Konsolidimi territorial shënon reformën më të rëndësishme administrative në vend, me riorganizimin e njërive të vetëqeverisjes vendore nga 373 njësi (308 komuna dhe 65 bashki) në 61 bashki, duke siguruar bazën për një decentralizim eficient, efektiv dhe demokratik, në përputhje me parimet e Kartës së Autonomisë Vendore.

Reforma Administrative Territoriale (RAT) u pasua nga decentralizimi i një sërë funksionesh të qeverisja vendore. Sot më shumë se kurdoherë, bashkitë kanë më shumë kompetenca dhe burime të nevojshme për t'u shërbyer qytetarëve. Transferimi i kompetencave është shoqëruar në mënyrë të vazhdueshme me mbështetje financiare nga ana e qeverisë qendrore, e cila e konsideron agjendën e decentralizimit një përparësi të rëndësishme në kuadër të procesit të mirëqeverisjes dhe të integritimit evropian. Harmonizimi ligjor midis ligjit organik nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligjeve sektoriale ka pasur gjithashtu vëmendje të shtuar gjatë periudhës pas RAT-it.

Decentralizimi gjithësesi nuk është një zgjidhje e menjëhershme e të gjithë sfidave në nivel vendor, por një proces holistik dhe i vazhdueshëm që synon përmirësimin dhe forcimin e demokracisë vendore, pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje, mirëfunksionim të institucioneve, shërbime eficiente për qytetarët dhe zhvillim të qëndrueshëm e përfshirës. Në këtë perspektivë ka ende nevojë për të intensifikuar bashkëpunimin ndërmjet qeverisë vendore dhe asaj qendrore, për të përputhur kuadrin ligjor mbi funksionet, për të konsoliduar zbatimin e funksioneve të reja, si dhe për rritje të vazhdueshme të kapaciteteve të bashkive, shoqëruar me menaxhim më eficient të financave vendore dhe mirëqeverisje.

SNDQV-ja 2023–2030 përmban disa elemente të reja që diktohen nga momenti historik i hapjes së negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian në korrik 2022 dhe nga konteksti kombëtar i përparësive të zhvillimit që ka sjellë në fokus transformimin dhe qeverisjen digjitale.

Në perspektivën evropiane Shqipëria duhet të zbatojë tërësisht arritjen e deritanishme të legjislationit të Bashkimit Evropian, duke kontekstualizuar përputhshmërinë me të gjithë kapitujt tematikë. Ky është një proces i gjatë i saponisur, që do të sjellë një transformim rrënjësor politik, ekonomik dhe social të vendit, me një ndikim dhe përfitim të drejtpërdrejtë, por dhe nevojën për një angazhim aktiv të qeverisjes vendore.

Nga ana tjetër, qeverisja digjitale/*e-qeverisja* është sot një realitet i prekshëm në institucionet publike qendrore shqiptare, veçanërisht në fushën e dhënies së shërbimeve administrative. Progresi i kryer në këtë fushë, kryesisht në dekadën e fundit, kulmoi me vendimin për dhënien pothuajse ekskluzive të të gjitha shërbimeve qendrore *online* që prej 1 majit 2022. Ky transformim do të vazhdojë të thellohet dhe do të përfshijë dhe qeverisjen vendore, si pjesë përbërëse të *e-qeverisjes*.

Në këtë frymë, strategjia e re për decentralizimin dhe qeverisjen vendore synon konsolidimin e mëtejshëm të procesit të decentralizimit, shërbime cilësore e gjithëpërfshirëse dhe eficiencë e transparencë sipas standardeve evropiane. Këta objektiva synohen të arrihen nëpërmjet rritjes së kapaciteteve vendore, menaxhimit të integruar të aseteve vendore, përmirësimit të ofrimit të shërbimeve vendore, duke përfshirë dhe digjitalizimin e shërbimeve vendore dhe përmirësimin e infrastrukturës së ofrimit të tyre, rritjes së autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta, përmirësimit të demokracisë vendore, përparimit të agjendës së integritimit evropian në nivel vendor, si dhe konsolidimit të mëtejshëm të kapaciteteve të strukturave administrative qendrore në mbështetje të qeverisjes vendore.

Një element i rëndësishëm për t'u theksuar në procesin e hartimit të strategjisë është qasja nga poshtë lart, duke marrë në konsideratë perspektivën e qeverisjes vendore në zbatimin e SNDQV-së në tërësi dhe ushtrimin të funksioneve në veçanti. Megjithatë është po aq e rëndësishme të theksohet se SNDQV-ja është një strategji ndërsektoriale, e cila përveç ministrive të linjës dhe agjencive shtetërore relevante, si institucione përgjegjëse dhe kontribuuese, përfshin edhe njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) si zbatuese të drejtpërdrejta të një sërë masash. Aktorë të tjerë në mbështetje të zbatimit të SNDQV-së janë shoqatat e qeverisjes vendore, partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit dhe organizatat joqeveritare.

Strategjia mbulon periudhën 2023–2030, për t'i dhënë mundësinë agjendës së decentralizimit për ndërhyrje holistike dhe kuptimplotë në koordinim dhe në përputhje kohore me Strategjinë

Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE), kjo e fundit gjithashtu në linjë me Agjendën 2030 të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo strategji përmban dhe një Plan veprimi, i cili është hartuar fillimisht për një periudhë 3-vjeçare dhe përfshin aktivitete dhe masa afatshkurtra dhe me rezultate të afërta në kohë.

Parimet, metodologjia dhe struktura

Parimet

Disa nga parimet kryesore të marra në konsideratë dhe që mbështesin këtë Strategji, janë:

- Decentralizimi nuk është qëllim në vetvete, por një mjet për të përmirësuar vendimmarrjen, për të shpërndarë dhe administruar më me eficiencë burimet, për të promovuar zhvillimin dhe për të përmirësuar dhënien e shërbimeve sa më afër dhe në mënyrë sa më të barabartë për të gjithë qytetarët.

- Decentralizimi nuk është një formulë e ngurtë, por një proces vetëvlerësimi dhe reformimi i vazhdueshëm, që synon shpërndarjen optimale të përgjegjësisë dhe burimeve midis nivelit qendror dhe atij vendor.

- Qeveritë vendore janë aktorë të rëndësishëm dhe aktivë në politikën e zhvillimit dhe në agjendën e integritit evropian.

- NJVV-të funksionojnë në sinergji dhe në përputhje me politikën dhe përparësitë kombëtare.

- NJVV-të funksionojnë në respekt të parimeve dhe të vlerave themelore, veçanërisht në adresimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut, të barazisë gjinore dhe të parimit “askush të mos mbetet pas” (*leave no one behind*)¹.

- Decentralizimi dhe qeverisja vendore mbështeten në një qasje me shumë aktorë, ku qeveria qendrore, qeveritë vendore dhe shoqëria civile kontribuojnë në nivele të ndryshme.

- Si qeveria qendrore, ashtu edhe ajo vendore kanë nevojë për kapacitete për përmirësimin e planifikimit, menaxhimit dhe zbatimit të agjendës së decentralizimit dhe të qeverisjes vendore.

- Qeverisja vendore është një shtytëse e rëndësishme për promovimin dhe ushqyerjen e demokracisë dhe të pjesëmarrjes qytetare, e cila nga ana tjetër kërkon forcimin e përgjegjshmërisë dhe të transparencës së qeverisjes vendore.

- Ofrimi i shërbimeve është në qendër të mandatit të qeverisjes vendore dhe për këtë arsye, qasja e përmirësuar, efikase dhe e barabartë në ofrimin e shërbimeve është thelbësore për një qeverisje vendore funksionale dhe të përgjegjshme.

- Për të përmbushur mandatet e tyre, qeveritë vendore kanë nevojë për burime të parashikueshme dhe të qëndrueshme, kapacitete për rritjen e të ardhurave të tyre, si dhe mbështetje për përmirësimin e menaxhimit financiar.

Metodologjia

Procesi i hartimit të kësaj strategjie ka filluar në prill 2022 me miratimin e planifikimit të planit strategjik, sipas urdhrorit të Kryeministrit nr. 76, datë 22.4.2022, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës dhe të grupit teknik të punës për hartimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore e të planit të veprimit, 2023–2030”. Nga maji deri në fund të gushtit 2022 është organizuar një fushatë e gjerë e marrjes së mendimeve dhe konsultime me NJVV-të dhe institucione qendrore për perspektiven e tyre në lidhje me SNDQV-në e planin shoqëruar të veprimit, ndërkohë që ekspertë të fushave të ndryshme janë angazhuar për të bërë vlerësime dhe analiza tematike. Në vjeshtë 2022 ka filluar zhvillimi i draftit të parë të strategjisë, që më pas u

¹ *Leave No One Behind* është premtimi qendror transformues i Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Objektivave të saj të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Ai përfaqëson angazhimin e qartë të të gjitha shteteve anëtare të OKB-së për të çrrënjësuar varfërinë në të gjitha format e saj, për t'i dhënë fund diskriminimit dhe përjashtimit dhe për të reduktuar pabarazitë dhe dobësitë që i lënë njerëzit pas dhe minojnë potencialin e individëve dhe të njerëzimit në tërësi. <https://unsdg.un.org/2030-agenda/universal-values/leave-no-one-behind>.

përmirësua duke iu nënshtruar konsultimeve vlerësuese të cilat përfunduan në dhjetor 2022 me një draft të përparuar që iu paraqit gjithë aktorëve.

Procesi i hartimit të SNDQV-së ka pasur një qasje të bazuar në evidenca për formulimin e politikave, shoqëruar nga konsultimi gjithëpërfshirës me aktorët kryesorë. Procesi ka pasur po aq rëndësi sa dhe rezultati, pasi bazat e procesit kanë qenë gjithëpërfshirja dhe sidomos pjesëmarrja e aktorëve.

Inputet janë marrë nëpërmjet inventarizimit të zbatimit të funksioneve të qeverisjes vendore nga 61 bashkitë. Ky ushtrim ka evidentuar se çfarë ka funksionuar mirë dhe nevojën për të përmirësuar/ndërhurë në funksionet e qeverisjes vendore. *Inputet* nga NJVV-të, përfshirë edhe shoqatat përkatëse, kanë përcaktuar përparësitë e drejtimeve strategjike dhe masat specifike të agjendës së decentralizimit. Paralelisht ministritë e linjës dhe agjencitë shtetërore, si aktorë kryesorë të zbatimit të SNDQV-së, kanë dhënë perspektivën e tyre lidhur me objektivat strategjike dhe masat konkrete. Partnerët e zhvillimit kanë pasur një kontribut të rëndësishëm në procesin e hartimit të strategjisë, nëpërmjet ekspertizës së tyre gjatë viteve të fundit, si dhe me angazhimin e ekspertëve të fushave të ndryshme për të ndërmarrë studime, analiza dhe për të kontribuar drejtpërdrejtë në formulimin e SNDQV-së. Organizatat e shoqërisë civile gjithashtu kanë pasur vëmendjen e duhur në të gjitha hallkat e procesit të hartimit.

Struktura

Ky dokument strategjik përfshin një kontekst hyrës dhe pesë kapituj kryesorë. Kapitulli 1 përshkruan ecurinë e deritanishme të procesit të decentralizimit dhe të qeverisjes vendore, parimet dhe metodologjinë e ndjekur në hartimin e SNDQV-së 2023–2030 dhe institucionet përgjegjëse e kontribuuese. Kapitulli 2 fokusohet në mësimet e nxjerra nga zbatimi i strategjisë së mëparshme, duke nënvizuar çfarë ka ecur mirë dhe çfarë duhet bërë për të adresuar dobësitë në të ardhmen. Kapitulli 3 përshkruan në detaje qëllimin, objektivat dhe masat e propozuara për zbatimin e SNDQV-së 2023–2030. Kapitulli 4 detajon mekanizmat e propozuar të llogaridhënies, monitorimit dhe raportimit, si dhe përgjegjësitë e përbashkëta institucionale për zbatimin e strategjisë dhe është i lidhur ngushtë me shtojcën 1 – Indikatorët strategjikë. Kapitulli 5 identifikon burimet financiare të nevojshme për zbatimin e strategjisë dhe lidhet ngushtë me shtojcën 2 – Plani i veprimt.

Kapitulli 1 - Konteksti, arritjet dhe sfidat

Konteksti dhe arritjet

Reforma Administrative Territoriale nëpërmjet miratimit të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” shënoi reformën më të rëndësishme administrative në vend që nga viti 1992. Riorganizimi i Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) nga 373 njësi (308 komuna dhe 65 bashki) në 61 bashki eliminoi fragmentarizimin, rriti efikasitetin dhe efencën në ofrimin e shërbimeve dhe përmirësoi dukshëm autonominë fiskale vendore.

Në vijim të riorganizimit administrativo-territorial, në vitin 2015 u miratua Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, që konfirmoi vizionin e Qeverisë Shqiptare dhe përcaktoi objektivat e procesit të decentralizimit në Shqipëri, objektiva të cilat u ruajtën edhe me rishikimin e përditësimin e Planit të Veprimt në një periudhë 2020–2022. Në përputhje me këtë plan të rishikuar, katër shtyllat kryesore strategjike të SNDQV-së janë si më poshtë:

A. Konsolidimi i kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësisve të vetëqeverisjes vendore, i cili përfshin tre objektiva specifike:

- i. konsolidimi i kapaciteteve të strukturave administrative;
- ii. aplikimi i shërbimeve të integruara administrative me teknologjinë e informacionit për 61 bashki dhe njësitë e tyre administrative;

iii. forcimi i dialogut mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore dhe llogaridhënies së dyanshme).

B. Forcimi i financave vendore dhe i autonomisë fiskale, i cili përfshin pesë objektiva specifikë:

i. konsolidimi i sistemit të të ardhurave të veta vendore dhe administrimit fiskal vendor;

ii. rritja e ndarjes së të ardhurave nga taksat kombëtare me bashkitë;

iii. përmirësimi i parashikueshmërisë, stabilitetit dhe përshtatshmërisë së sistemit të transfertave qeveritare;

iv. rritja e kapaciteteve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) për të përdorur huamarrjen për financimin e projekteve kapitale, brenda politikave kombëtare të borxhit publik;

v. forcimi i sistemit të menaxhimit të financave publike në nivelin vendor.

C. Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm vendor, i cili përfshin tre objektiva specifikë:

i. zbatimi efikas i funksioneve të veta bazuar në një kuadër ligjor të qartë dhe të harmonizuar;

ii. sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik vendor;

iii. ngritja dhe përditësimi i standardeve minimale kombëtare për shërbimet vendore.

D. Forcimi i qeverisjes së mirë në nivelin vendor, i cili përfshin katër objektiva specifikë:

i. sigurimi i qeverisjes së hapur, rritja e transparencës, përgjegjshmëria dhe shtrirja më e madhe e e-qeverisjes në nivel vendor;

ii. Integrimi Evropian dhe qeveria vendore;

iii. forcimi i strukturave komunitare në nivel vendor (komisionet qytetare, kryetarët e fshatrave, ndërlidhësit qytetarë);

iv. zbatimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore.

Me anë të ligjit organik nr. 139/2015, NJVV-ve iu njohën një sërë fushash kryesore të përgjegjësisë vendore, duke përcaktuar rreth 41 funksione. Përcaktimi i përgjegjësive historike nuk ndryshoi në mënyrë drastike nga periudha para strategjisë dhe reformës territoriale, por ndër 41 funksionet vendore të përcaktuara me ligj, 7 prej tyre u transferuan për herë të parë nën kompetencën vendore në vitin 2015, duke përfshirë fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, shërbimeve sociale, kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese, mbrojtjes së mjedisit, bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, zhvillimit ekonomik vendor, sigurisë publike dhe në 2019 kompetenca në fushën e diasporës dhe migracionit.

Në të njëjtën frymë, ndryshime të rëndësishme ligjore vijuan, ndër të cilat kuadri ligjor dhe nënligjor për financat vendore, mbledhjen e taksës së pasurisë së paluajtshme/kadastrën fiskale, taksat vendore, udhëzimet për buxhetimin e qeverisjes vendore, kuadri rregullator për planifikimin dhe zhvillimin e territorit mbi hartimin dhe detajimin e planeve të përgjithshme vendore të territorit.

Për sa i përket konfigurimit institucional, ka pasur një sërë zhvillimesh në strukturat e qeverisjes qendrore lidhur me decentralizimin dhe qeverisjen vendore në periudhën pas RAT-it, siç ishte ngritja dhe funksioni i Këshillit Konsultativ ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore dhe struktura të qeverisjes qendrore përgjegjëse për politikën dhe zbatimin e agjendës së decentralizimit në nivel vendor (Drejtoria e Çështjeve Vendore në Ministrinë e Brendshme dhe Agjencia për Zbatimin e Reformës Administrative Territoriale, e cila më vonë u shndërrua në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore).

Si domosdoshmëri e decentralizimit të burimeve të financimit për ushtrimin e funksioneve të sipërcituara, u miratua ligji i financave vendore nr. 68/2017, i cili përcaktoi rregullat e menaxhimit të financave publike në nivel vendor, si edhe parimet dhe procedurat e qarta mbi financimin e qeverisë vendore nga burimet vendore. Ky kuadër i dedikuar ligjor për financat vendore, shoqëruar edhe me transferta specifike për funksionet e deleguara, solli përparim të dukshëm të decentralizimit fiskal në vend, me synim për të krijuar një sistem transparent dhe gjithëpërfshirës për alokimin e transfertave të pakushtëzuara për qeverisjen vendore.

Nga këndvështrimi ligjor, së bashku me zhvillimet e mësipërme strategjike dhe legjislativë, proceset e mësipërme u pasuan me një sërë ndryshimesh të aspekteve të ndryshme të ligjeve sektoriale dhe akteve nënligjore për vetëqeverisjen vendore, me synim ndërtimin e një kuadri gjithëpërfshirës për funksionet e decentralizuara, me fokus ato të decentralizuara rishtazi. Rëndësi iu vu procesit të harmonizimit ligjor midis ligjit organik nr. 139/2015 dhe ligjeve sektoriale me qëllim eliminimin e pengesave ligjore dhe institucionale në ekzekutimin e funksioneve nga ana e bashkive. Një analizë e detajuar e bazës ligjore (Matrica e kompetencave)² orientoi Ministrinë e Brendshme për përcaktimin e përparësive të rekomandimeve/ndryshimeve ligjore të nevojshme, me qëllim menaxhimin efikas të funksioneve të deleguara. Në vijim, një mori vendimesh, udhëzimesh dhe aktesh të tjera nënligjore u miratuan, çka rriti dukshëm shkallën e harmonizimit ligjor, si një ndër objektivat kryesorë të strategjisë së mëparshme.

Në terma të kuadrit strategjik, si domosdoshmëri e një vlerësimi më të detajuar dhe kumulativ të masave të zbatuara në kuadër të SNDQV-së 2015–2020, u ndërmor Rishikimi Afatmesëm i Strategjisë, i cili theksoi rëndësinë e objektivave të SNDQV-së për nevojat e qeverisjes vendore, duke vlerësuar Strategjinë aktuale si të rëndësishme dhe të vlefshme për NJVV, ndërsa vetë procesi i decentralizimit përfitoi nga një përditësim i Planit të Veprimit të Strategjisë në 2020–2022³. Rishikimi afatmesëm argumenton se “strategjia mbetet e dobishme dhe e vlefshme për nevojat e të gjithë aktorëve të përfshirë dhe ku është bërë një progres i rëndësishëm” në agjendën e decentralizimit. Përtej këtij vlerësimi afatmesëm, SNDQV-ja është monitoruar në mënyrë të rregullt në vitet 2016, 2017, 2020 dhe 2021.

Progresi strategjik i parë në këndvështrimin administrativ, funksional dhe fiskal është vlerësuar në masën 67%⁴. Gjithsesi, theksohet se ky progres nuk reflekton tërësisht shkallën e zbatueshmërisë, për shkak të disa mangësive në procesin e raportimit nga ana e institucioneve përgjegjëse, që jo domosdoshmërisht përputhet me shkallën e realizimit. Progresi strategjik sipas 4 shtyllave të sipërcituara jepet si më poshtë.

A. Konsolidimi i kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore

Gjatë viteve të zbatimit të SKDQV-së është arritur progres i mirë veçanërisht për konsolidimin e kapaciteteve të strukturave administrative (100% realizueshmëri), aplikimin e shërbimeve të integruara administrative me teknologjinë e informacionit për 61 bashki dhe njësitë e tyre administrative (50%) dhe forcimin e dialogut mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore dhe llogaridhënies së dyanshme (75%)⁵. Gjatë viteve të fundit bashkitë janë përqendruar më së shumti tek administrimi i territorit nëpërmjet hartimit të planeve të përgjithshme vendore, të cilët konsiderohen si një gur themeli në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, dhe me ndikim në të ardhurat vendore. Deri në vitin 2022, mbi 90% e bashkive kanë hartuar dhe janë duke zbatuar Planet e Përgjithshme Vendore (pjesa tjetër në proces hartimi)⁶. Ndërsa disa bashki, si Tirana, Shkodra, Korça apo të tjera kanë konkretizuar tashmë vizionin e tyre zhvillimor në plane më të përparura, ato strategjike, të cilat orientojnë punën e bashkive jo vetëm në aspektin urbanistik, por edhe atë ekonomik.

² Mbështetur nga Delegacioni Evropian në Shqipëri. Më shumë informacion në lidhjen: <https://bpe.al/al/matrica-e-kompetencave-e-vet%C3%ABqeverisjes-vendore-2019>

³ Vendimi nr. 783, datë 07.10.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të veprimit 2020–2022, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020”.

⁴ Raporti i Monitorimit i Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2022). Ministria e Brendshme/Agjencia për Mbështetjen dhe Vetëqeverisjen Vendore.

⁵ *Ibid*

⁶ AKPT (2022). <https://planifikimi.gov.al/index.php?id=732>. Bashkitë Tepelenë, Dropull, Memaliaj, Selenicë dhe Shijak ende nuk i kanë hartuar planet e tyre.

Arritje të tjera të rëndësishme lidhen me ofrimin e shërbimeve administrative në zyra me një ndalesë, ku rezulton një aktivitet tërësisht i mbuluar dhe tashmë i orientuar me nismë të Qeverisë Shqiptare në ofrimin e shërbimeve *online*⁷. Numri i aplikimeve *online* për shërbime administrative në nivel vendor është rritur në mënyrë progresive nga njëri vit në tjetrin (nga 373 në vitin 2018 në 35,191 në shtator 2022)⁸. Që me nismën e qeverisë qendrore për shërbime *online*, vetëm gjatë gjashtë muajve të fundit shënohen 4189 shërbime, me 152 shërbime unike⁹.

Lidhur me strukturat institucionale dhe burimet njerëzore, fokusi gjatë periudhës pas RAT-it ka qenë platforma *administrata.al* dhe trajnimi i ekipit në nivel vendor, i shoqëruar me vlerësimin e nevojave për trajnim. Platforma funksionon që nga viti 2019 dhe ka përmirësuar ndjeshëm komunikimin, duke shënuar një hap më tej drejt unifikimit dhe standardizimit të procedurave dhe praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore. Përveç këtyre, është siguruar që bashkitë të prezantohen me modele të strukturave sipas standardeve. AMVV-ja me mbështetjen e partnerëve të zhvillimit¹⁰ ka krijuar disa modele strukturash (në vitin 2015 dhe 2018) orientuese për të ndihmuar në organizimin e brendshëm të bashkive.

Një aspekt i rëndësishëm i kësaj shtylle të strategjisë/planit të veprimit 2015–2022 është edhe forcimi i dialogut mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore dhe llogaridhënies së dyanshme, ku më së shumti arritjet janë evidentuar te fuqizimi i Këshillit Konsultativ (KK). Ky Këshill është forumi kryesor¹¹ ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore për konsultimin e strategjive të reja, politikave dhe legjisllacionit që kanë ndikim te qeverisja vendore. Roli i tij në forcimin e dialogut institucional dhe koordinimin ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore ka ardhur në rritje të vazhdueshme si nga këndvështrimi sasior, ashtu edhe cilësor i diskutimeve mbi projektaktet e konsultuara, veçanërisht vitet e fundit ku intensiteti i mbledhjeve është rritur ndjeshëm (nga 3 projektakte më 2017 në 236 në vitin 2022).¹²

B. Forcimi i financave vendore dhe i autonomisë fiskale

Ecuria e treguesve kryesorë fiskalë dhe financiarë të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri ka qenë pozitive, me tregues të përmirësuar dukshëm krahasimisht me periudhën para strategjisë. Në veçanti, forcimi i financave vendore është një ndër sukseset e agjendës së decentralizimit pas riorganizimit administrativo-territorial. Rritja e përgjegjësive të qeverisjes vendore, shoqëruar me një kuadër ligjor të dedikuar, solli si domosdoshmëri edhe një kërkesë për autonomi më të madhe fiskale.

RAT-i ndikoi drejtpërdrejt në performancën financiare të NJVV-ve duke rritur me rreth 2.3 herë të ardhurat nga taksat e veta vendore në vitin 2022 krahasuar me vitin 2015. Të ardhurat vendore kanë një rritje domethënëse dhe qeverisja vendore ka më shumë mjete financiare, falë rritjes së burimeve të veta vendore, taksave të ndara dhe transfertave nga qeveria qendrore. Pesha e të ardhurave të buxhetit vendor ndaj PBB-së është dyfishuar (1.63% në 2021 krahasuar me 0.82% në 2015). Po ashtu të ardhurat nga burimet e veta (të ardhura tatimore dhe jotatimore) të njësive të vetëqeverisjes vendore në vitin 2021 kanë arritur në vlerën 29.4 miliardë lekë ose 2.5 herë më shumë se në vitin 2015 (11.7 miliardë lekë). Mbi 80% e NJVV-ve shënojnë rritje të konsiderueshme të të ardhurave të veta vendore, duke konsoliduar në këtë mënyrë kapacitetin e tyre fiskal për financimin e shërbimeve vendore.

Figura 1. Të ardhurat e veta vendore në raport me të ardhurat publike dhe PBB-në

⁷ Me mbështetjen e partnerëve të zhvillimit si PNUD-i, Delegacioni Evropian, Qeveria Zvicerane, Qeveria Suedez dhe USAID-i.


⁸ Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (2022).

⁹ Të dhënat raportohen vetëm për 52 bashkitë të cilat operojnë me OSSIS (Sistemin e zyrës me një ndalesë).

¹⁰ PNUD

¹¹ European Commission Staff Working Document, Albania 2022 Report https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

¹² Këshilli Konsultativ ka përfituar asistencë teknike nga USAID dhe më pas nga Delegacioni i Bashkimit Evropian.



Ndër burimet e veta vendore në rritje të konsiderueshme vlen të përmenden të ardhurat nga taksat e pasurisë, të cilat kanë arritur 6.1 miliardë lekë ose 56% më shumë se në vitin 2015, falë rikonceptimit dhe përmirësimit të theksuar të mbledhjes dhe administrimit të tyre. Fuqizimi i qeverisjes vendore për të realizuar politika zhvillimore dhe dinamika e zhvillimit urban është reflektuar në rritje të të ardhurave nga “taksa e ndikimit në infrastrukturë” në rreth 9.5 miliardë lekë ose rreth 8.1 miliardë lekë më shumë se të ardhurat para reformës nga ky burim i bashkive. Taksa e ndikimit në infrastrukturë përbënte rreth 32% të të ardhurave të veta vendore në vitin 2021 dhe është elementi kryesor që ndikon në rritjen e të ardhurave të veta, krahas taksave të pasurisë. Rritja e taksave të pasurisë ndihmon në një rritje të qëndrueshme të burimeve vendore, në ndryshim nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe të ardhurat jotatimore. Modeli evropian sugjeron që në një perspektivë afatgjatë ka shumë hapësirë për rritjen e të ardhurave nga taksim i pronës. Reforma e taksës së pasurisë synon të mbështesë ndërtimin dhe zbatimin e një sistemi gjithnjë e më të drejtë, më modern, transparent dhe të qëndrueshëm për taksimin e pasurive të paluajtshme që do të sigurojë nivele të përshtatshme të të ardhurave vendore për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Përvoja nga vende të tjera që kanë zbatuar reforma të përmasave të tilla provojnë se ato janë teknikisht sfiduese dhe mund të marrin, në varësi nga parakushtet, nga 5 deri në 15 vjet për të prodhuar rezultate të qëndrueshme.

Rritja e cilësisë së shërbimeve të drejtpërdrejta që përfitojnë qytetarët është reflektuar edhe në rritjen e të ardhurave nga tarifat vendore. Tarifa e pastrimit është rritur me një mesatare 500 milionë lekë për të gjitha NJVV-të çdo vit pas reformës. Megjithatë, duhet theksuar se tarifa e pastrimit mbetet në nivele relativisht të ulëta në krahasim me kostot e shërbimit.

Edhe pse në shtatë vitet e fundit qeverisja vendore ka përmirësuar ndjeshëm kapacitetin financiar, rritja e përgjegjësisë vendore dikton nevojën e burimeve shtesë për qeverisjen vendore, nëpërmjet një autonomie më të madhe fiskale si në këndvështrimin e shumëllojshmërisë së burimeve, ashtu edhe në diskrecionin mbi normat e taksave vendore; shoqëruar me rritje të performancës së mbledhjes së të ardhurave të veta.


Mbështetja e qeverisë qendrore me transfertën e pakushtëzuar është rritur në mënyrë progresive pas miratimit të ligjit për financat vendore, gjë e cila ka sjellë një parashikueshmëri më të madhe të të ardhurave të veta. Kjo mbështetje ka qenë e qëndrueshme pavarësisht nga problemet, si pasojë e pandemisë COVID-19, tërmetit, krizës ekonomike dhe asaj energjetike. Në vitin 2015 (viti i parë i reformës administrative territoriale), transfertat e pakushtëzuar ka qenë në vlerën 12.3 miliardë lekë,

ndërkohë në vitin 2021 arriti në vlerën 18.4 miliardë lekë, pra me një rritje prej 49.5%. Të ardhurat e veta të bashkisë plotësohen nga transfertat e pakushtëzuar (transferta e përgjithshme dhe sektoriale), e cila synon mbulimin e diferencës mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojës për shpenzime) dhe të ardhurave të bashkive që ato krijojnë në mënyrë të pavarur (kapaciteti fiskal).

Pesha e shpenzimeve vendore ndaj shpenzimeve të qeverisë së përgjithshme gjithashtu ka rritje të qëndrueshme gjatë viteve, që prej 2015-ës¹³, duke arritur në 2.97% më 2021 nga 2.38% më 2015 (shih figura 2). Shpenzimet e qeverisjes vendore janë rritur ndjeshëm që nga viti 2015, konkretisht me 54% (52,6 miliardë lekë më 2021 krahasuar me 34,1 miliardë lekë në 2015), duke ndikuar drejtpërsëdrejti në ekonominë e vendit (nëpërmjet investimeve infrastrukturale), ashtu edhe në konsumin (nëpërmjet pagave të punonjësve). Bashkitë e orientojnë atë drejt më shumë investimeve dhe shërbimeve publike. Shpenzimet e qeverisjes vendore janë rritur me 67.6%, ndërsa të ardhurat nga taksat vendore janë rritur me rreth 217% ose mbi 2 herë (11.7 miliardë lekë më 2015 në 26.6 miliardë lekë më 2021).

Përveç aspekteve fiskale, financat vendore njohin përmirësim edhe për sa i përket aspektit rregullator si prezantimi dhe përdorimi i treguesve të performancës në PBA (rritja e cilësisë së monitorimit), ulja e numrit të programeve buxhetore (nga 36 programe në 20 programe buxhetore), të janë pasqyruar edhe në uljen e stokut të detyrimeve të prapambetura të NJVV-ve (45% ulje krahasuar me vitin e parë të RAT¹⁴, duke dëshmuar për një disiplinë më të mirë fiskale.

Figura 2. Buxheti vendor në vite në raport me shpenzimet e përgjithshme dhe PBB-në



C. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor

Kjo shtyllë e planit të veprimit 2015–2022 përfshin tri blloqe kryesore: i) Zbatimi efikas i funksioneve të veta bazuar në një kuadër ligjor të qartë e të harmonizuar; ii) Sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik vendor; si edhe iii) Ngritja dhe përditësimi i sistemeve të standardeve minimale kombëtare për shërbimet vendore. Arritjet kryesore të periudhës pas RAT-it janë evidentuar te zbatimi i funksioneve, ndërsa dy të tjerat kanë pasur progres të kufizuar.

¹³ Përfshijtur një ulje të vogël (me 0.1 pikë përqindje në bazë vjetore) në vitin 2020, si pasojë e tkurrjes së shpenzimeve kapitale nën trysinë e pandemisë COVID-19.

¹⁴ Detyrimet e prapambetura për qeverisjen vendore në vitin 2016 kanë qenë në vlerën rreth 12.1 miliardë lekë dhe krahasuar me 6-mujorin e parë të vitit 2022 janë ulur me rreth 5 miliardë lekë ose rreth 41%. Të dhënat nga MFE-ja.

Në fushën e funksioneve të veta, si ato historike, ashtu edhe ato të deleguara në kuadër të thellimit të procesit të decentralizimit, në tërësi vërehen përmirësime të konsiderueshme. Rikonfigurimi i qeverisjes vendore ka mundësuar hedhjen e hapave cilësorë në sigurimin e shërbimeve, veçanërisht në ofrimin e shërbimeve sociale, menaxhimin e mbetjeve të ngurta; menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë, planifikimit dhe realizimit të investimeve të një shkalle më të gjerë. Në mënyrë të përmbledhur, disa nga arritjet kryesore që evidentohen si në nivel objektiv strategjik, ashtu edhe në nivel funksioni janë si më poshtë:

Në fushën e arsimit numri i kopshteve është rritur me 259 (1897 në 2015 kundrejt 2,156 në 2021), dhe numri i edukatorëve me rreth 467 (4672 në 2015 në 5141 në 2021)¹⁵. Ky funksion financohet përmes transfertës sektoriale, e cila rezulton në rritje që nga momenti i transferimit të këtij funksioni te qeverisja vendore dhe mbulon shpenzimet për personel mësimor e jomësimor (në vitin 2018 me 12%) dhe me ritme më të moderuara në vitet pasuese në 2020 me 2% e 2021). Në arsimin parauniversitar, transferata sektoriale shkon në përfitim të 57 bashkive.

Në fushën e përfshirjes sociale është evidentuar progres gjatë viteve pas RAT-it në hartimin e planeve sociale vendore. Aktualisht 60 bashki kanë hartuar plane sociale vendore krahasuar me zero bashki në vitin 2015. Krijimi i shërbimeve të koordinuara të riintegritimit për përfituesit e Ndhmës Ekonomike dhe komunitetet e cenueshme është një objektiv i përfshirë në të gjitha planet sociale vendore, megjithatë kapacitetet për riintegrim ndryshojnë sipas bashkisë. Numri i shërbimeve vendore të kujdesit social është rritur në mënyrë të vazhdueshme ndër vite. 493 shërbime sociale ofrohen nga 339 institucione publike, jopublike dhe të formës së përzier. 46% e shërbimeve sigurohen nga institucione publike, ndërsa pjesa tjetër sigurohen nga institucione jopublike. Në të gjithë vendin përfitojnë shërbime sociale 42,553 individë ose 1.5% e popullsisë për vitin 2021. Përtej progresit strategjik, bashkitë përballen me sfida në lidhje me shtrirjen e shërbimeve, burimet njerëzore dhe financiare, cilësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre. Në rang vendi raportohet se janë 244 qendra të cilat ofrojnë shërbime sociale për kategori të ndryshme. Më konkretisht, gjatë vitit 2021 janë hapur 16 shërbime të reja sociale për të gjithë grupet e synuara në nevojë. Këto shërbime kanë një shtrirje gjeografike në të gjithë vendin¹⁶.

Ndërsa lidhur me programet e asistencës shoqërore – përfitimet në para (*cash*) për reduktimin e varfërisë (skema e NE dhe pagesa për PAK dhe kujdestarët e tyre) zbatohen nga bashkitë si një funksion i deleguar, në emër të ministritë përgjegjëse për mbrojtjen sociale. Roli i bashkive për administrimin e procesit të aplikimeve, vlerësimin të nevojave, menaxhimin të rasteve dhe pagesës së përfitimeve është megjithatë thelbësor dhe ka ngarkesë të konsiderueshme.

Në fushën e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike investimet kapitale vendore veçanërisht nga të ardhurat e veta janë në përgjithësi të ulëta dhe të paqëndrueshme. Një pjesë e tyre e konsiderueshme vjen nga grantet e kushtëzuara, përfshirë Fondin e Zhvillimit të Rajoneve apo investime të drejtpërdrejta nga Ministrinë e linjës. Roli i NJVV-ve në skemat kombëtare të financimit të investimeve në territoret dhe funksionet e tyre duket se ka ardhur në zbehje.

Spektori i furnizimit me ujë dhe kanalizime njih përmirësime të vazhdueshme në aspektin e cilësisë së ujit dhe sistemit të kanalizimeve veçanërisht për sa u takon investimeve në ngritjen dhe/ose përmirësimin e rrjetit të kanalizimeve, me fokus në zonat bregdetare, apo edhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane. Gjithsesi, është një sektor me raste informaliteti, amortizimi të sistemit të furnizimit apo edhe efektshmëri të ulët operacionale. NJVV-të veprojnë si aksionerë të vetëm të ndërmarrjeve të ujësjellësve (58 shoqëri të UK dhe 151 sisteme të ujësjellësve rurale). Mbulimi i territorit e veçanërisht i zonave rurale u rrit. Gjithsesi riorganizimi i shoqërive UK sipas parimit 1 shoqëri = 1 bashki nuk është përfunduar nga të gjitha shoqëritë UK/bashkitë. Aktualisht 58 shoqëritë UK me

¹⁵ AMVV (2022).

¹⁶ Shërbimi Social (2022) <https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/raporti-vjetor-2021-full.pdf>

100% të aksioneve në zotërim nga NJVV-të përballen me një performancë të dobët financiare, nga ku 46 shoqëri subvencionohen nga qeveria qendrore për mbulimin e kostove operacione të mirëmbajtjes. Ndaj qeveria qendrore, me qëllim përmirësimin e ofrimit të këtij shërbimi, planifikoi zbatimin e një reforme thelbësore në sektor me qasje kryesore rajonalizimin përmes agregimit të shoqërive të UK-së, me qëllim krijimin e ekonomisë së shkallës dhe sigurimin e standardit në ofrimin e shërbimit dhe investimeve të mëdha infrastrukturale.

Në fushën e transportit publik jo të gjitha bashkitë e ofrojnë këtë shërbim (22 nuk e ofrojnë), ndërsa mbetet një shërbim i nënfinancuar¹⁷. Bashkitë më së shumti merren me dhënien e lejeve/ose miratimet paraprake për transport urban dhe interurban. Shpenzimet për transportin publik zënë rreth 1% të totalit të buxhetit të bashkive¹⁸.

Në fushën e mjedisit progresi është i lidhur përgjithësisht me shtimin e sipërfaqeve të gjelbra, mbjelljen e pemëve dhe fushatat ndërgjegjësuere për mbrojtjen mjedisit¹⁹, si masa për përmirësimin e mjedisit e cilësisë së ajrit, edhe pse shoqërohet me paqartësi për sa i përket ndarjes së pushteteve mes niveleve të ndryshme të qeverisjes.

Lidhur me mbetjet, RAT ishte një hap i madh dhe pozitiv në lidhje me eficiencën e shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Mbulimi i popullsisë me shërbimin bazë është përmirësuar dukshëm (60% më 2015 në 89% më 2021)²⁰, ndonëse kënaqësia e njerëzve me shërbimin është rreth 45%, afërsisht në të njëjtin nivel me shërbimet e tjera. Impiantet e trajtimit të mbetjeve thuajse po përfundojnë ose janë parashikuar të investohen në të gjithë rajonet/zonat e mbetjeve duke arritur që pjesa më e madhe e vendit të trajtojë mbetjet në impiante të licencuar e modernë, duke nënvizuar nga ana tjetër edhe koston e konsiderueshme për trajtimin e mbetjeve. Vend-depozitimet e përdorura më përpara kanë nevojë për një përpjekje serioze financiare, investimi në projektet e mbylljes të së cilave, mund të jetë përtej mundësive të bashkive.

Në fushën e sigurisë transferimi të bashkitë konsiderohet një arritje e procesit të decentralizimit: më 2021 krahasimisht me 2015 ka më shumë stacione të MZSH-së për bashkitë, si dhe burime njerëzore dhe pajisje e mjete për ofrimin e këtij shërbimi (38 stacione në 2015 kundrejt 70 stacione më 2020) dhe më shumë mbulim në territor me punonjës për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri dhe shpëtimin (738 punonjës më 2015 kundrejt 1250 punonjës më 2021). Ndërsa, mbrojtja civile njihet arritje përgjithësisht ligjore (miratimi i ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe paketës së akteve nënligjore) të cilat kanë qartësuar kompetencat dhe rolin e autoriteteve vendore në fushën e mbrojtjes civile duke i dhënë rol të qartë strukturave vendore në parandalimin, përballimin, vlerësimin e dëmeve dhe rindërtimi.

D. Forcimi i qeverisjes së mirë në nivel vendor

Shtylla e katërt dhe e fundit e strategjisë 2015–2022 fokusohet te forcimi i qeverisjes së mirë në nivel vendor nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të punonjësve të administratës vendore për të dhënë shërbime më të mira, të transparenca dhe llogaridhënia në rritje e strukturave të qeverisjes vendore, ashtu si dhe të ndjekja e agjendës së integritetit evropian në nivel vendor. Në këndvështrimin e progresit strategjik, ky objektivi është ndër objektivat me realizueshmëri të lartë²¹.

Progres i rëndësishëm është arritur në transparencën e veprimtarisë së këshillave të cilët kanë tashmë faqet e tyre në internet, publikojnë rregullisht vendimet, si dhe transmetojnë drejtpërsëdrejti mbledhjet e këshillave, mundësuar kjo prej përmirësimit të ndërfaqeve të këshillave bashkiakë sipas

¹⁷ Vetëm disa bashki të mëdha financojnë në mënyrë aktive shërbimin.

¹⁸ “Raport Studimor Performanca e Shërbimeve Publike të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore 2021”, Gusht 2022.

¹⁹ Agjencia Kombëtare e Mjedisit (2022). <https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/>

²⁰ INSTAT (2022).

http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_EN_MU/MU02/table/tableViewLayout1/

²¹ 84% në nivel objektiv. Më shumë informacion te Raporti i Monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2020–2022 të Ministrisë së Brendshme.

standardeve vendore. Këto përmirësime mundësojnë gjithashtu funksionimin e regjistrave elektronikë të konsultimit dhe të trajtimit të kërkesave (fizikisht dhe *online*). Është shënuar gjithashtu një përmirësim i balancës gjinore në këshillat bashkiakë, në të cilët numri i grave të zgjedhura është rritur nga 35% më 2015 në rreth 45% më 2020²².

Gjithashtu, raportohet ecuri e suksesshme lidhur me ndërgjegjësimin e bashkive mbi transparencën dhe integritetin. 21 bashki²³ kanë hartuar dhe janë duke zbatuar planet e tyre të integritetit, ndërkohë që asnjë bashki nuk ka pasur më parë një plan të tillë. Bashkitë kanë tashmë metodologjinë për hartimin e Planit të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes. Zbatueshmëria varion nga 50-80% që vitin e parë të hartimit të planit në disa prej bashkive²⁴. Ndërsa procesi i hartimit të këtyre planeve ka ndjekur një qasje vullnetare nga ana e bashkive, tashmë është e nevojshme plotësimi i të gjitha bashkive me plane të personalizuar të integritetit.

Aspekti i fundit i kësaj shtylle ka të bëjë me përparimin e agjendës së integritetit evropian në nivel vendor nëpërmjet arritjes së standardeve dhe zbatimit të praktikave të mira të BE-së në nivel vendor, rritjes së kapaciteteve të administratës vendore për të përmbushur rolin e tyre në procesin e integritetit, përfshirë atë lidhur me absorbimin dhe zbatimin e projekteve të financuara nga BE, krijimin e partneriteteve ndërbashkiake dhe rajonale me NJVV-të në vendet fqinje nëpërmjet programeve ndërkufitare dhe ndërkombëtare.

Aktualisht të gjitha bashkitë kanë ngritur njësitë e tyre të Integritetit Evropian, sipas udhëzimeve ligjore. Ndër të tjera, këto njësi janë aftësuar për të raportuar lidhur me performancën e bashkive në këndvështrimin e procesit të Integritetit Evropian. Gjithashtu vërehet se është bërë progres i rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve absorbuese të bashkive për projekte me fonde të BE-së. Në 5 vjetet e fundit (2017–2021) bashkitë janë përfituese të 148 projekteve, ku pjesa më e madhe e tyre financohen nga programet IPA²⁵. Vetëm në 2021 bashkitë janë përfituese të 74 projekteve nga BE-ja.

Sfidat

Përtej arritjeve të akumuluar gjatë viteve, procesi i decentralizimit ka hasur një sërë sfidash²⁶, për të cilat adresimi i tyre do të konsolidonte më tej decentralizimin duke siguruar shërbime me cilësi më të lartë, më afër qytetarëve dhe më eficientë në të gjithë territorin e vendit, sikurse shfrytëzimi i gjithë potencialit të saj për shërbime cilësore drejt zhvillimit ekonomik vendor. Në mënyrë të përgjithshme ato renditen si më poshtë:

- Autonomia financiare dhe pamjaftueshmëria e burimeve financiare për bashkitë në ushtrimin e plotë dhe me efektivitet të funksioneve të tyre ka nevojë për forcim të mëtejshëm, përtej arritjeve shumë të mira në këtë drejtim. Sfidë mbetet shtimi i taksave të ndara në favor të qeverisjes vendore, veçanërisht rentës minerare dhe tatimit mbi të ardhurat personale, si dhe sigurimi i mbështetjes për krijimin e kadastrës fiskale.

- Mungesa e standardeve minimale në ofrimin e shërbimeve vendore është vënë në dukje gjatë ofrimit të shërbimeve nga bashkitë, për të cilën nevojitet një standard i mirëpërcaktuar me qëllim rritjen e ofrimit të shërbimeve të qytetarët. Është e rëndësishme që shërbimi të ofrohet në mënyrë të njëjtë të qytetarët, pavarësisht nga diferencat në bashki. Në të njëjtën kohë, për të monitoruar ofrimin dhe performancën e shërbimeve sipas standardeve të mirëpërcaktuara, nevojitet një instrument për të kuptuar në mënyrë empirike progresin e agjendës së decentralizimit në tërësi apo

²² Të dhënat për 2015 marrë nga “Gender Quotas and Women Substantive Representation in the Local Council in Albania”, UNDP Albania 2017, ndërsa për 2021 nga vëzhgimi i të dhënave të listave për Këshill Bashkiak.

²³ Patos, Elbasan, Mallakastër, Mat, Gjirokastër, Durrës, Belsh, Berat, Bulqizë, Lezhë, Përmet, Pogradec, Tiranë, Lezhë, Shijak, Maliq, Has, Kukës, Pukë, Kavajë, Himarë, Roskovec.

²⁴ Raporti Vjetor i vitit 2021 i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

²⁵ Të dhënat nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (2022).

²⁶ Në përputhje edhe me Komisionin e Posaçëm të Reformës Administrative Territoriale (2022).

sipas bashkive specifike, sikurse edhe për ta lidhur këtë informacion në të ardhmen me transfertat për qeverisjen vendore.

- Mungesa e qëndrueshmërisë së burimeve njerëzore në nivel vendor, për të cilët kërkohet adresim duke rishikuar nivelin e pagave dhe incentivuar burimet njerëzore, me qëllim sigurimin e një administrate të aftë dhe të mirëpaguar, veçanërisht në bashkitë me numër të vogël banorësh.

- Paqartësitë ligjore dhe/ose administrative të kompetencave të qeverisjes vendore, përtej procesit konstant të harmonizimit ligjor, duhet të adresohen në përputhje të plotë të ligjeve sektoriale me ligjin organik nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”. Përmirësimi i legjislacionit sektorial në fushat e funksioneve të bashkive mbetet i një rëndësie të lartë.

- Digjitalizimi dhe sfidat e shoqëruara me këtë proces të lidhura me ofrimin e shërbimeve administrative apo edhe të aspekteve të tjera të një qeverisje vendore të hapur dhe transparente përbëjnë një sfidë aktuale. Për të përfituar nga teknologjia në mënyrë të plotë, kërkohen përpjekje të vazhdueshme për të siguruar qëndrueshmëri dhe gjithëpërfshirje (askush të mos mbetet pas/leave no one behind).

- Nevoja për forcim të mëtejshëm të demokracisë vendore, për sa i përket përfaqësimit gjithëpërfshirës (veçanërisht të zonave rurale dhe njësive administrative), forcimi i rolit të Këshillit Bashkiak për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë së ekzekutivit, dhe qartësimin të kompetencave të administratorëve dhe rolit të njësive administrative, si dhe e strukturave komunitare.

- Rishikimi i rolit dhe i kompetencave të qarkut në përputhje me rolin e tij për zbatimin e politikave rajonale, harmonizimin e tyre me politikat shtetërore në nivel qarku, bazuar gjithashtu në përcaktimet e ligjit për zhvillimin rajonal.

- Bashkitë nuk kanë shfrytëzuar potencialin e tyre të territorit lidhur me asetet dhe burimet natyrore, e cila vështirësohet edhe nga procesi i ngadaltë i transferimit dhe i regjistrimit të pronave. Gjithashtu, një numër i kufizuar bashkish kanë përdorur incentivat ekzistuese për marrëveshje ndërbashkiake me qëllim rritjen e ekonomive të shkallës. Kjo sfidë së bashku me të mësipërmet janë aktuale në kontekstin ekonomik të bashkive të vendit.

Kapitulli 2 – Mësimet e nxjerra

Në të gjitha konsideratat e mësipërme, angazhimi i qeverisë qendrore dhe bashkëpunimi ndërinstitucional mbetet kyç në realizimin e objektivave të SNDQV-së së re. Përparimi dhe konsolidimi i mëtejshëm i agjendës së decentralizimit kërkon një bashkëpunim dhe koordinim të vazhdueshëm me të gjithë aktorët e përfshirë. Ky proces nuk përbën vetëm aspektin e harmonizimit ligjor, por edhe atë administrativ, me qëllim zbatimin sa më efikas dhe ofrimin cilësor të shërbimeve nga ana e qeverisjes vendore. Në veçanti, procesi i decentralizimit përfiton nga dialogu ndërinstitucional, qeverisje qendrore – qeverisje vendore, me qëllim diskutimin dhe për pasojë kalibrimin e procesit të decentralizimit lidhur me politikat, strategjitë dhe pa dyshim harmonizimin ligjor.

Decentralizimi simetrik kundrejt decentralizimit asimetrik është një çështje e maturuar tashmë për diskutim, analizë dhe vendimmarrje, veçanërisht pas konsolidimit të rolit të bashkive në garantimin e shërbimeve cilësore dhe afër qytetarëve. Nëse decentralizimi asimetrik është një opsion i realizueshëm, kjo kërkon analiza të thelluara paraprake mbi zbatimin e të gjitha funksioneve. Asimetria mund të jetë në bazë të disa kriterëve të mirëpërcaktuara (si p.sh. statusi ekonomik i një bashkie, statusi metropol, statusi gjeografik etj.). Nga ana tjetër, vazhdimi me decentralizimin simetrik sërish kërkon hulumtime mbi shfrytëzimin e marrëveshjeve ndërvendore për të rritur ekonominë e shkallës në ofrimin e një/disa shërbimeve. Të tilla marrëveshje janë praktikuar nga bashkitë me njëra-tjetrën, shpeshherë në forma modeste e në disa raste edhe të formalizuara (rasti i mbetjeve apo i ujësjellësit). Është e qartë se mund të ketë çështje të rëndësishme për t'u analizuar

dhe eventualisht përmirësuar në kuadrin ligjor, administrativ dhe fiskal për të lehtësuar përdorimin e këtyre marrëveshjeve, por sidoqoftë përvetësimi dhe forcimi i rolit të bashkive në ushtrimin e funksioneve duhet të mirëmbështetur në të tria aspektet e sipërcituara (ligjor, administrativ dhe financiar).

Përfitimet e marrëveshjeve ndërvendore janë gjerësisht të njohura dhe lidhen me ekonominë e shkallës (ulje të kostove për njësi), ndarjen e roleve dhe përgjegjësi, ndarjen e risqeve e përfitimeve dhe ofrimi i produkteve /shërbimeve më cilësore dhe në sasi më të madhe²⁷. Si të tilla, marrëveshjet duhet të riletësohen dhe të përdoren si mjete për nxitjen e bashkëpunimit ekonomik ndërvendor.

Në kuadër të ofrimit të shërbimit të qytetarët, me qëllim rritjen e cilësisë së tyre, është e rëndësishme që shërbimi të ofrohet në mënyrë të njëjtë të qytetarët, pavarësisht nga diferencat në madhësi të bashkive. Në këtë fushë nevojiten përpjekje të shumta nga institucionet kombëtare dhe koordinim i vazhdueshëm, shoqëruar me burime të konsiderueshme. Deri tani një ndër fushat e pakta ku duket se janë përcaktuar standardet e shërbimeve është ujësjellësi, menaxhimi i mbetjeve, arsimiti parashkollor dhe shërbimi për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri, si edhe ofrimi i shërbimeve administrative (Zyra me një ndalesë), edhe pse janë të një karakteri të ndryshëm nga standardi i ofrimit të shërbimeve utilitare. Në lidhje me përcaktimin dhe/ose përditësimin e standardeve të shërbimeve të ofruara nga NJVV-të, këto të fundit janë përgjegjëse për administrimin dhe organizimin e ofrimit të shërbimeve publike, si edhe për ngritjen e një njësie të veçantë për vendosjen e standardeve të ofrimit të shërbimeve publike dhe monitorimit të performancës së tyre.

Një aspekt vizionar dhe sërish transversal i strategjisë është nisma e Qeverisë mbi digjitalizimin e shërbimeve dhe ofrimin e tyre *online*. Nevoja për digjitalizim u kthye në dosmodoshmëri gjatë pandemisë, si një proces i cili diktoi ndryshime të rëndësishme në mënyrën e ofrimit të shërbimit si në nivel qendror, ashtu edhe atë vendor. Ky proces synon të rrisë transparencën e shërbimeve publike, efikasitetin në terma kohorë, monetarë dhe cilësorë, eventualisht uljen e shpenzimeve të qytetarëve dhe bizneseve në marrjen e këtyre shërbimeve.

Kapitulli 3 – Strategjia e re Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023–2030

Vizioni

Në kuadër të përmirësimit të mbarëvajtjes së këtij procesi, vlerësohet se momentalisht ka ende nevojë për të intensifikuar bashkëpunimin ndërmjet qeverisë vendore dhe asaj qendrore, për të përputhur bazën ligjore (me akte ligjore dhe nënligjore) me funksionet, implementimin e funksioneve të reja dhe vazhdimin e punës për rritje të kapaciteteve të bashkive, shoqëruar me menaxhim më eficient të financave vendore dhe mirëqeverisje, me qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik vendor të qëndrueshëm. E rëndësishme është qasja nga poshtë lart, duke marrë në konsideratë perspektivën e qeverisjes vendore në zbatimin e SNDQV-së në tërësi dhe ushtrimin të funksioneve në veçanti.

Objektivat e përcaktuar në këtë dokument strategjik janë në harmoni të plotë me standardet dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian mbi përparimin e mëtejshëm të agjendës së decentralizimit dhe konsolidimit të arritjeve ekzistuese, ashtu si dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo strategji mbështetet në fusha të njëjta me strategjinë 2015–2022, por duke përmirësuar dhe përparuar masat e secilit objektiv, sikurse ushtrimi i funksioneve në mënyrë autonome nga këndvështrimi financiar dhe demokracia vendore e perspektiva evropiane me qëllim arritjen e zhvillimit ekonomik vendor të qëndrueshëm.

Vizioni për qeverisjen vendore dhe decentralizimin në periudhën 2023–2030 ***është një qeverisje vendore e cila promovon vlerat demokratike dhe orientohet drejt rritjes ekonomike***. Në këtë frymë, strategjia ***synon konsolidimin e procesit të decentralizimit për të fuqizuar qeverisjen***

²⁷ <https://rm.coe.int/imc-intermunicipal-co-operation/1680746ec3>

vendore për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm drejt standardeve evropiane, mbështetur mbi qëllimet politike kryesore të cilat synojnë krijimin e një mjedisi nxitës për zhvillimin ekonomik vendor të qëndrueshëm, forcimin e të ardhurave vendore të bashkive, digjitalizimin e shërbimeve dhe ofrimin e tyre *online*, sigurimin e një qeverisjeje të hapur, rritje të transparencës, llogaridhënies; shtrirjen më të madhe të e-qeverisjes në nivel vendor, përparimin e agjendës së BE-së në nivel vendor, si edhe zhvillimin e forcimin e kapaciteteve të nevojshme vendore dhe qendrore për një qeverisje funksionale gjithëpërfshirëse të aktorëve të decentralizimit.

Ndërlidhjet me agjendat e integritimit evropian dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm

Në përputhje dhe zbatim të SKZHIE-së 2021–2030, SNDQV-ja orientohet nga agjenda e Integritimit Evropian të Shqipërisë dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke marrë në konsideratë integrimin gjinor dhe “për të mos lënë askënd pas” në të gjithë shtyllat e saj.

Integrimi evropian

Anëtarësimi i Shqipërisë në BE përbën synimin politik dhe strategjik të vendit dhe synon integrimin ekonomik, politik, juridik, dhe socio-kulturor të tij, proces i cili mbështet në zbatimin e reformave dhe politikave në përputhje me standardet e BE-së. SKZHIE-ja parashtrohet në mënyrë të detajuar rëndësinë e procesit dhe masat në zbatim të lidhura me këtë proces në përgjithësi dhe qeverisjen vendore në veçanti, përfshirë forcimin e kapaciteteve institucionale të njësisve të qeverisjes vendore për procesin e anëtarësimit. Integrimi në BE është një proces sfidues që kërkon shumë përpjekje të administratës qendrore dhe vendore. Krijimi i një administrate publike joburokratike, profesionale dhe transparente, e aftë për të përballuar sfidat që sjell integrimi në BE dhe përthithja e fondeve të BE-së është një nga synimet kryesore në përparimin e reformës së administratës publike në nivel vendor.

Kapitujt e përafrimit të legjislacionit, *Acquis Communautaire*, përkojnë në një pjesë të madhe me përmbushje të standardeve dhe të kriterëve të cilat janë ekskluzivisht përgjegjësi e bashkive. Në kushtet kur afër 70% e legjislacionit evropian do të duhet të zbatohet në nivel vendor, roli i bashkive bëhet thelbësor në rrugëtimin e Shqipërisë në procesin e Integritimit Evropian. Kështu kjo strategji lidhet dhe harmonizohet me SKZHIE-në jo vetëm në drejtim të shtyllës 1 “Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë”, por të qëllimit parësor politik e strategjik të Shqipërisë, atë të Integritimit Evropian.

Procesi i anëtarësimit mund të përfitojë shumë nga përfshirja e qeverisjes vendore. Zbatimi i standardeve të integritimit në BE është një proces shumë i rëndësishëm dhe sfidues. Ndërsa procesi i anëtarësimit përparon, më shumë kërkesa do të shtrohen përpara drejtuesve dhe administratave të qeverisjes vendore për t’u siguruar që qytetarëve t’u ofrohen të njëjtat shërbime si qytetarëve të tjerë të BE-së dhe që demokracia vendore të zbatohet në mënyrë efikase dhe gjithëpërfshirëse.

Strategjia Evropa 2020 thekson rolin e rëndësishëm të qeverive vendore, duke theksuar shprehimisht se: “*Të gjitha autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale duhet të zbatojnë partneritetin, duke i lidhur ngushtë parlamentet, partnerët socialë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, duke kontribuar në përpunimin e programeve kombëtare të reformave dhe për zbatimin e tij. Dialogu midis qeverisë qendrore, rajonale dhe vendore do t’i sjellë prioritetet e BE-së më afër njerëzve, duke forcuar ndjenjën e pronësisë së nevojshme për të përfshirë të gjithë në lëvizjen e Evropës drejt objektivave të 2020-ës.*”²⁸

Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm

Duke identifikuar objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) me SNDQV-në, dhe mbi të gjitha me treguesit strategjikë, kjo strategji merr në konsideratë harmonizimin e zbatimit të saj me arritjen e OZHQ-ve, pjesë e Agjendës 2030, për të cilat Shqipëria është plotësisht e angazhuar deri në përfundimin e procesit në vitin 2030. Kjo agjendë përmban 17 objektiva²⁹, të cilat synojnë një

²⁸Komisioni Evropian, Strategjia Evropa 2020.

²⁹ <https://sdgs.un.org/goals>

zhvillim të qëndrueshëm në shumë përmasa. SNDQV-ja, si një strategji ndërsektoriale, ka referenca në të gjithë objektivat, por në mënyrë të detajuar jepen te treguesit e përzgjedhur strategjikë, të cilët lidhen drejtpërdrejt me impaktin e dëshiruar në përputhje me OZHQ-të.

Si një objektiv i rëndësishëm i OZHQ-ve, integrimi i elementit gjinor në mënyrë sistematike në strategji siguron që politikat dhe ligjet t'i përgjigjen në mënyrë më efektive dhe të drejtpërdrejtë nevojave të të gjithë qytetarëve – grave dhe burrave, vajzave dhe djemve. Përtej faktit që barazia gjinore trajtohet posaçërisht në Strategjinë e Barazisë Gjinore 2021–2030, barazia gjinore është një çështje horizontale, me ndikim të padiskutueshëm në agjendën e decentralizimit. Në këtë frymë elementi gjinor është integruar, ku është e mundur, në të gjitha masat e qëllimeve politike të kësaj strategjie.


Së dyti, duke pasur në vëmendje të veçantë objektivin “askush të mos mbetet pas” *leave no one behind*, kjo strategji merr në konsideratë përfaqësimin, përfshirjen dhe marrjen e masave për adresimin e pabarazive që i lënë grupe të caktuara njerëzish në disfavor ose disavantazh. Në këtë kontekst, kjo strategji bën përpjekje për të identifikuar individët e “lënë pas”, arsyet, si edhe masa për adresimin e shkaqeve lidhur me të gjithë qëllimet politike të SNDQV-së 2023–2030 dhe Planit të Veprimit 2023–2025.

Qëllimet politike

Në funksion të vizionit të kësaj strategjie, qëllimet politike, janë:

1. Nxitja dhe forcimi i zhvillimit të qëndrueshëm vendor;
2. Përmirësimi i cilësisë, i standardeve dhe i ofrimit të shërbimeve vendore;
3. Zgjerimi i qeverisjes digjitale në nivel vendor për të ofruar shërbime dhe programe qeveritare në mënyrë më eficiente, transparente dhe me kosto efektive;
4. Rritja e autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta;
5. Përmirësimi i demokracisë vendore dhe përparimi i agjendës së integritimit evropian në nivel vendor;
6. Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të nevojshme vendore dhe qendrore dhe i një koordinimi e qeverisjeje funksionale gjithëpërfshirëse të aktorëve të decentralizimit.

Qëllimet 3 dhe 6 konsiderohen si përshpejtuese të qëllimeve të tjera të strategjisë, të cilat shërbejnë si katalizatorë horizontale drejt vizionit të një qeverisjeje vendore, e cila nxit e mbështet vlerat demokratike dhe orientohet drejt rritjes ekonomike.



Qëllimi politik 1: nxitja dhe forcimi i zhvillimit të qëndrueshëm vendor

Përtej hapave domethënës në fushën e funksioneve të veta, qëllimi politik i 3-të e strategjisë së mëparshme ka pasur një fokus shumë të kufizuar mbi çështjet e zhvillimit ekonomik vendor, në të cilën burimet u përqendruan në vijimin e shërbimeve dhe njohjen e konsolidimit e territoreve të reja. Rezultate pozitive janë arritur në kuadrin e planifikimit të përgjithshëm strategjik të bashkive dhe forcimin e zhvillimit bujqësor dhe rural. Nga ana tjetër, planifikimi ekonomik strategjik është trajtuar me përparësi vetëm nga disa bashki të mëdha (p.sh. Tirana, Shkodra), të cilat e kanë konsideruar territorin si një mundësi zhvillimi ekonomik dhe jo thjesht urbanistik.

Një sfidë tjetër e rëndësishme në këtë drejtim është menaxhimi josistematik i aseteve dhe i burimeve natyrore vendore. NJVV-të nuk menaxhojnë në mënyrë efektive burimet e tyre, përfshi këtu asetet publike. Ndër problemet shoqëruese në këtë kontekst është procesi i inventarizimit dhe i transferimit të pronave të paluajtshme publike shtetërore apo zyrtarizimi i aseteve në përgjithësi. Ligji i vetëqeverisjes vendore parashikon që NJVV-të kanë të drejtë të gjenerojnë të ardhura nga përdorimi, shitja ose dhënia me qira e aseteve të bashkisë. Megjithatë procesi i transferimit të pronësishë ligjore mbi pronat e bashkive i shoqëruar me procesin e regjistrimit kontabël të tyre është larg të qenit i përfunduar, duke penguar kështu qoftë ruajtjen dhe mirëmbajtjen e objekteve, qoftë edhe shfrytëzimin e këtij burimi të rëndësishëm të të ardhurave në bashki.

Kësaj i shtohet sfida e sigurimit të titujve të pronësisë, pamundësia financiare e një pjese të madhe të NJVV-ve për të përballuar kostot e transferimit dhe regjistrimit, si dhe bashkëpunimi institucional jo në nivelin e duhur me institucionin qendror të regjistrimit të pasurive. Kostoja e përgatitjes së materialeve të regjistrimit të pronës (prodhimi i materialeve hartografike si plane rievimi dhe plane të cilat kërkohen si pjesë e dokumentacionit të regjistrimit) rezultojnë një shumë e konsiderueshme, e cila varet nga numri i pronave për t'u regjistruar.

Gjatë këtyre viteve, qeveria është përpjekur të finalizojë transferimin e pasurive publike drejt NJVV-ve, por procesi ende nuk ka përfunduar. Situata duket problematike edhe lidhur me regjistrimin e pronave. Kuadri institucional dhe ai ligjor lidhur me këto procese duket mjaft kompleks dhe i është nënshtruar një sërë ndryshimesh.

Përveç planeve të territorit, në periudhën pas RAT-it bashkitë janë përqendruar në vijimin dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe infrastrukturës bazë social-ekonomike dhe shtrirjes së tyre në territor duke rritur mbulimin territorial. Ndërsa funksionet e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor janë komplekse dhe shumëaktoriale (bashkia, qarku, qeveria qendrore dhe aktorë

të tjerë si biznes, shoqata, partnerë zhvillimi), instrumentet/nxitësit e marrëveshjeve ndërvendore mbeten ende të paeksploruara. Bashkitë nuk kanë përdorur në mënyrë të plotë skemat dhe incentivat vendore ndaj bizneseve dhe organizatave joqeveritare, që mund t'i atribuohet jo vetëm mospërdorimit të instrumenteve ligjore ekzistuese, por edhe paqartësisë ligjore e administrative (në disa raste).

Ndonëse ka disa raste të marrëveshjeve përgjithësisht ndërbashkiake (rasti i mbetjeve në qarkun Korçë), sërish shfrytëzimi i këtij instrumenti është në nivele të ulëta. Në të njëjtën linjë edhe qarku është një aktor i rëndësishëm në bashkëpunimin ndërvendor dhe shfrytëzimin e ekonomive të shkallës, si një argument për bashkëpunimin ndërvendor.

Ndërlidhja midis zhvillimit ekonomik vendor dhe atij rajonal është rregulluar edhe në legjislacionin për zhvillimin rajonal dhe kohezionin, por edhe këtu duket se qarku nuk e ka shfrytëzuar këtë kompetencë. Për të gjitha qarqet vihet re një rritje e PBB-së për frymë që nga viti 2015 (si vit referencë). Gjithsesi, harta tregon që pavarësisht nga rritja, qarqet nuk kanë përfutur njëlloj, duke nënvizuar pabarazitë rajonale³⁰.

Nga ana tjetër, veçanërisht trashëgimia kulturore nuk ka marrë vëmendjen e duhur në strategjinë dhe planin e veprimit të mëparshëm. Kultura në përgjithësi është trajtuar vetëm në aspektin e harmonizimit ligjor dhe jo si një funksion që mund të përdoret për shfrytëzim ekonomik, e kësaj për maksimizimin e të ardhurave vendore. Për këtë funksion evidentohet nevoja për qartësimin e funksioneve dhe përgjegjësi në fushën e trashëgimisë kulturore në lidhje me rishikimin e kuadrit ligjor dhe ngritjen e një sistemi të integruar të zhvillimit të zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në nivel vendor e përdorimi i tyre për qëllime të zhvillimit ekonomik. Kjo për shkak të mospërcaktimit të qartë të kompetencave nga qeveria qendrore në rastin e kalave dhe objekteve të tjera muzeale, si dhe mungesës së inventarëve për të gjitha asetet e tjera të cilat vijojnë të jenë të pashfrytëzuara apo të nënshfrytëzuara.

Lidhur me zhvillimin bujqësor, grupet vendore të veprimit (LAG/GVV), një instrument i zhvillimit bujqësor/rural nëpërmjet sipërmarrjes dhe punësimit lokal, mbeten një sfidë e prekshme për t'u përdorur/nxitur nga bashkitë në rolin e tyre të katalizatorit për nxitjen e bashkëpunimit vendor në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Problematika të tjera, si siguria e digave dhe kapacitetet e përshtatshme për garantimin e sigurisë së tyre nevojiten të adresohen në kuadër të zhvillimit bujqësor.

Duke pasur në konsideratë çka u përmend më sipër dhe progresin e kufizuar mbi zhvillim ekonomik vendor, qëllimi politik i parë nxjerr në pah funksionin e zhvillimit ekonomik vendor të NJVV-ve me anë të rijetësimit të instrumenteve ndërvendore të bashkëpunimit, si *nxitja e marrëveshjeve ndërbashkiake* për të rritur ekonominë e shkallës, përfshirë këtu edhe qartësimin apo harmonizimin e kuadrit ligjor me qëllim ushtrimin e plotë të kompetencave ekzistuese lidhur me zhvillimin ekonomik vendor, *shfrytëzimin eficient të burimeve/aseteve/kapitalit natyror në nivel vendor, përdorimin e kompetencave ekzistuese në funksion të zhvillimit ekonomik, lehtësimin e procesit të transferimit e regjistrimit të pronave publike të NJVV-ve, si edhe mbështetje me grante të dedikuara për qëllime të zhvillimit ekonomik.*

Objektivat specifikë

Strategjia propozon masa të cilat synojnë të përforcojnë dhe mbështesin rolin e bashkive dhe qarqeve në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik vendor, duke u dhënë instrumentet dhe hapësirën e duhur për të vënë në përdorim dhe maksimizuar asetet natyrore, ekonomike e kulturore.


³⁰ PBB për frymë më e lartë vihet re në Tiranë (90,611 lekë), Durrës (56,3170 lekë), Fier (61,8812 lekë) dhe Gjirokastrë (61,4013 lekë). Ndërsa, kjo PBB pasohet nga Berati dhe Vlora. Nga ana tjetër, Kukësi (46,803.89 lekë) shënon vlerën më të ulët të PBB-së për frymë. Ndonëse të gjitha rajonet kanë vlera pozitive të rritjes krahasuar me 2015 (normat e rritjes variojnë nga 12% deri në 23%).

Mungesa e një vizioni koherent dhe e koordinimit midis aktorëve përbën sfidë në këtë fushë, krahas pengesave për disponimin dhe shfrytëzimin e aseteve vendore dhe orientimit të pamjaftueshëm të kapaciteteve vendore drejt shfrytëzimit të aseteve vendore për të gjeneruar vlerë të shtuar në nivelin vendor.

Një sërë nismash në mbështetje të rolit të bashkive të mbështetura edhe nga qeveria qendrore për zhvillimin ekonomik (rajonal) nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) do të luajnë rolin e katalizatorit për zhvillimin ekonomik vendor, përfshirë hartimin e një kuadri politik planifikues kombëtar/rajonal të koordinuar me planet vendore; vënie në funksionim të Bordeve Rajonale Vendore ku bashkitë e qarqet janë aktorë vendimtarë, nxitjen e ndërveprimit dhe sinergjive vendore/rajonale midis grupeve të interesit, si Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Destinacionit Rajonal dhe Vendor dhe mbështetja për energjizimin e aktivitetit prodhues e inovator përmes inkubatorëve të biznesit apo parqeve teknologjike, me orientim nga *smart cities* (qytete të zgjuara) apo qytete sociale dhe më afër qytetarëve. Gjithashtu, në strategji propozohet edhe mbështetje e drejtpërdrejtë/e tërthortë e qeverisë qendrore për nivelin vendor me qëllim zhvillimin ekonomik.

Objektivat specifikë të këtij qëllimi janë:

- objektivi specifik 1.1: përmirësimi i planifikimit ekonomik strategjik dhe përdorimi i skemave dhe incentivave vendore për zhvillim ekonomik ndaj bizneseve dhe organizatave joqeveritare, duke përfshirë rishikim të kuadrit ligjor;
- objektivi specifik 1.2: menaxhimi i integruar i aseteve dhe i burimeve natyrore vendore;
- objektivi specifik 1.3: forcimi i zhvillimit bujqësor dhe rural;
- objektivi specifik 1.4: mbështetja për fuqizimin e strukturave të turizmit dhe të trashëgimisë kulturore.



Objektivi specifik 1.1: Përmirësimi i planifikimit ekonomik strategjik dhe përdorimi i skemave dhe incentivave vendore për zhvillim ekonomik ndaj bizneseve dhe organizatave joqeveritare

Përfundimi i procesit të hartimit të planeve të përgjithshme vendore, si edhe hartimi i planeve strategjike zhvillimore.

Kjo masë synon përfundimin e procesit të hartimit të planeve të përgjithshme vendore me qëllim krijimin e një plani strategjik të sinkronizuar ndërmjet bashkive, si edhe nxitjen e nevojshme të sektorëve dhe aktorëve për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Planet strategjike janë aktet që orientojnë këtë zhvillim, duke bërë bashkë të gjithë aktorët dhe faktorët për zhvillim. Planet strategjike të zhvillimit do të orientohen drejt parimeve të ekonomisë së gjelbër, përfshirë ndërjegjësimin e strukturave vendore dhe komuniteteve për mjedisin si aset i rëndësishëm; përfshirjen e komunitetit dhe të bizneseve; zhvillimin urban me impakt sa më të ulët në mjedis; përdorimin eficient të burimeve dhe inkurajimin e shërbimeve publike miqësore për mjedisin.

Rijetësimi dhe prezantimi i incentivave/skemave të reja për marrëveshjet ndërbashkiake/ndërvendore dhe atyre me sektorin privat dhe organizatat joqeveritare.

Kjo masë nënkupton rijetësimin dhe/ose përditësimin e skemave dhe hapësirave ligjore ekzistuese, duke i bërë shteruese për sa u përket mekanizmave të përdorur, si edhe prezantimin e incentivave apo skemave të reja për marrëveshjet ndërmjet bashkive me njëra-tjetrën, ndërmjet bashkive dhe qarqeve, qarqeve me njëri-tjetrin, bashkive/qarqeve me biznesin dhe/ose organizatat joqeveritare. Për këtë kërkohet një analizë e detajuar e incentivave ekzistuese, arsyet e mospërdorimit të tyre, mundësitë e rijetësimit dhe së fundi skemat/incentivat e reja që mund të prezantohen në qeverisjen vendore. Gjithashtu, institucionet do të nxisin dhe krijojnë modele pozitive për bashkëpunimin ndërvendor të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet delegimit të këshillat e qarqeve të zbatimit të një pjese të funksioneve të veta të bashkive. Një pjesë e funksioneve të bashkive (ose pjesë të një funksioni) thjesht nuk mund të zbatohen pa bashkëpunuar me bashki të tjera ose pa deleguar një pjesë të Këshilli i Qarkut. Në funksione të tjera, përfitimi nga ekonomia e shkallës e krijuar nga një apo një tjetër formë bashkëpunimi është evident. Strategjia propozon studime për mënyrën më të mirë të ofrimit të këtij shërbimi (p.sh. nëpërmjet bashkëpunimit ndërvendor apo delegimit të këshillat e qarqeve) dhe do të sugjerojë mënyra, instrumente ligjore dhe mekanizmat të konkretizimit të formave të bashkëpunimit, për t'i bërë këto forma bashkëpunimi praktike dhe të zbatueshme.

Skema vendore për mbështetjen e bizneseve me grante apo shërbime të tjera.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, megjithëse me përparësi të ndryshme për sa u përket burimeve natyrore, mund të nxiten për të shfrytëzuar përparësitë që kanë lidhur me kapitalin natyror dhe asetet në territorin e tyre etj. Burimi i financimit për investimet fillestare mundësohet sipas kornizës ligjore “Për vetëqeverisjen vendore” nga të ardhurat e veta apo nëpërmjet huamarrjes për projekte ekonomike dhe financiare fitimprurëse.

Aktivizimi i shoqërive tregtare nga ana e bashkive, si e drejtë ligjore në ligjin e saj organik, mund të gjenerojë të ardhura në formën e fitimit. Përfitimet nga kjo mënyrë funksionimi do të jenë të kufizuara vetëm për shërbime që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të zonës, duke shmangur konfliktin me operatorët ekonomike me pronësi private. Shërbime të tilla mund të jenë organizimi i panairëve të produkteve të zonës në zona publike dhe të aksesueshme nga palët e interesuara.

Gjithashtu skema mbështetëse për NJVV-të do të prezantohen nga qeveria qendrore nëpërmjet granteve bazuar në performancën e tyre. Kjo mbështetje do të fokusohet në modernizimin e infrastrukturës vendore dhe inkurajimin e potencialit të zhvillimit ekonomik të bashkive dhe do të përmirësojë kushtet socio-ekonomike e mjedisore të komuniteteve lokale në Shqipëri, duke i përafëruar ato me standardet evropiane. Këto skema mund të zhvillohen nëpërmjet autoriteteve menaxhuese si FSHZH apo/dhe SASPAC, në bashkëpunim e koordinim me MB/AMVV.

Objektivi specifik 1.2: menaxhimi i integruar i aseteve dhe i burimeve natyrore vendore

Vënia në shfrytëzim e aseteve vendore si instrument i rritjes ekonomike vendore dhe burim për gjenerimin e të ardhurave

Në kuadër të përforsimit të rolit vendor në zhvillimin ekonomik, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të nxiten të identifikojnë, vlerësojnë, transferojnë dhe vënë në përdorim asetet vendore në funksion të përmbushjes së funksioneve të tyre dhe rritjes së mirëqenies e nivelit të ofrimit të shërbimeve në territoret përkatëse. Për këtë, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të nxiten dhe mbështeten për procesin e vlerësimit dhe klasifikimit të pronave/aseteve; për ndërtimin e një vizioni të përbashkët dhe inventarin e aseteve; përcaktimin e objektivave të zhvillimit dhe të treguesve për matjen e rentabilitetit; përcaktimin e burimeve financiare dhe politikave fiskale që mbështesin zbatimin e strategjisë. Kapacitetet e njësisve të vetëqeverisjes vendore do të zhvillohen për të vënë në

funksionim forma të shfrytëzimit të pasurive vendore për qëllime ekonomike apo sociale; nëpërmjet qiradhënies, bashkëinvestimit nëpërmjet formave të partneritetit publik privat; koncesioneve apo tjetërsimit. Mes të tjerash, kjo do të përfshijë edhe një bashkëpunim të zgjeruar ndërinstitucional në lehtësimin e procesit të transferimit të pronave publike të NJVV-të, me qëllim zhvillimin publik dhe vlerësimin e mundësisë së lehtësimin të formave të pagesës për regjistrimin e titujve të pronësisë në favor të NJVV-ve; një kuadër ligjor të unifikuar dhe të kombinuar me përgjegjësi të qarta të gjithë aktorëve që marrin pjesë në procesin e menaxhimit të aseteve, si edhe asistencë të vazhdueshme për ngritjen e njësisë koordinuese dhe udhëheqëse të procesit të menaxhimit të aktiveve, përmirësimin e kapaciteteve profesionale të ekipit, si dhe të audituesve të brendshëm të NJVV-ve.

Menaxhimi i kapitalit natyror

Bashkitë do të forcojnë rolin e tyre në menaxhimin e kapitalit natyror, duke ruajtur, zhvilluar dhe rijetësuar asetet në pronësi apo përdorim, përfshirë në veçanti asete natyrore, si pyjet dhe kullotat apo fondi i tokës bujqësore. Bashkitë do të koordinojnë punën e tyre në drejtim të planeve të përbashkëta të mbarështimit të pyjeve, me qëllim mbrojtjen e territorit, ruajtjen e hapësirës së përbashkët ndërbashkiake dhe uljen e kostove të bashkive, si dhe do të parashikojnë instrumente e plane për shfrytëzimin e kullotave dhe tokës bujqësore në funksion të zhvillimit ekonomik vendor. Kapitali natyror në përdorim të bashkive nuk kufizohet vetëm me pyjet, kullotat dhe tokën bujqësore – matja e kapitalit natyror është një fushë në zhvillim e sipër. Në këto kushte, bashkitë do të mbështeten për të ndërmarrë procesin e vlerësimin dhe monitorimit të aseteve natyrore që ato zotërojnë, përfshirë vlerësimin e kapitalit natyror nga çdo bashki në vend dhe planin e menaxhimit të tyre, me qëllim që asetet e identifikuar e vlerësuar në territorin e bashkisë të mund të menaxhohen e shfrytëzohen nga ajo. Ky proces do të kryhet bazuar në një metodologji të dakordësuar nga bashkitë mbi vlerësimin e kapitalit/aseteve.

Sistemi informativ për menaxhimin e aseteve vendore

Një sistem informativ për të menaxhuar asetet vendore do të rrisë eficiencën e njohjes dhe vlerësimin e eventualisht rritjen e të ardhurave të gjeneruara drejtpërdrejt ose tërthorazi nga asetet vendore. Rishikimi i kuadrit rregullator për menaxhimin e aseteve duhet t'i paraprijë ose të koordinohet me zhvillimin e një sistemi bashkëkohor për menaxhimin e aktiveve, i cili duhet të jetë kryesisht i nivelit menaxherial, komplementar dhe të sinkronizohet me informacione të prodhuara nga sisteme të tjera informative ekzistuese financiare të planifikimit dhe zbatimit, si Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) dhe Sistemi i Informacionit për Menaxhimin Financiar Vendor (SIMF-vendor). Në fushën e menaxhimit të aseteve të NJVV-ve synohet të vlerësohet mundësia e ndërtimit të një sistemi të menaxhimit të aseteve vendore, i cili mund të përdoret nga të gjitha NJVV-të, i integruar me sisteme të tjera që janë në administrim të institucioneve qendrore.

Objektivi specifik 1.3: forcimi i zhvillimit bujqësor dhe rural

Me qëllim rritjen e eficiencës së shërbimeve vendore në bujqësi dhe zhvillim rural propozohet një studim për mundësinë e zgjerimit të funksioneve dhe kompetencave të NJVV-ve në fushën e zhvillimit rural dhe bujqësisë. Gjithashtu do të nxitet roli i bashkisë për mbështetjen nëpërmjet financimit me grante dhe lehtësimi për aplikimin në skemat e AZHBR-së, për të orientuar çdo investim në përputhje me planet e përgjithshme vendore që në fazën fillestare. Në këtë mënyrë aplikimet do të kenë mundësi më të lartë për të qenë të suksesshme dhe impakti i investimeve të tilla do të përmirësojë gjithashtu edhe ekonominë e rajonit. Po ashtu, në kuadrin e masës LEADER të programeve IPARD, do të mbështetet krijimi i grupeve vendore të veprimit (GVV), një nismë e suksesshme në modelin evropian. Gjithashtu roli i bashkive në administrimin e rrjetit të ujitjes dhe të kullimit do të mbështetet më tej edhe nëpërmjet financimeve nga qeveria qendrore dhe fuqizimit të bashkërendimit të politikave për zhvillimin e rrjeteve parësore nën administrimin e MBZHR-së dhe

atyre dytësore e tretësore nën kompetencën bashkiake (grante për rehabilitimin e sistemit të ujitjes dhe të kullimit).

Objektivi specifik 1.4: mbështetja për fuqizimin e strukturave të turizmit dhe të trashëgimisë kulturore

Mbështetja për fuqizimin e strukturave të turizmit në nivelin vendor do të ofrohet bazuar mbi një vlerësim të kujdesshëm të kushteve dhe përputhshmërisë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe organizimin e strukturave koordinuese përtej territorit të NJVV-ve. Një pjesë e rëndësishme e punës në fushën e turizmit dhe trashëgimisë kulturore do të punohet për qartësimin e funksioneve e përgjegjësi në fushën e trashëgimisë kulturore. Rishikimi i kuadrit ligjor, si edhe ngritja e një sistemi të integruar të zhvillimit të zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në nivel vendor janë masa të parashikuara në kuadër të fuqizimit të strukturave të turizmit dhe trashëgimisë kulturore.

Bashkitë do të rrisin vëmendjen e tyre për të krijuar mjedise urbane miqësore; zhvillim hapësinor të qëndrueshëm, qasje të përshtatshme në objektet e trashëgimisë kulturore, natyrore dhe planifikimin e shërbimeve publike dinjitoze. Për këtë, aplikimi i instrumenteve inovative, si zonat e përmirësimit të biznesit dhe turizmit, do të zgjerohet në një numër më të madh bashkish për të rritur potencialin e kontributit të përbashkët nga sektori privat dhe ai publik në funksion të turizmit, zhvillimit ekonomik, përfshirë ekonominë blu dhe punësimin; do të intensifikohet bashkëpunimi i bashkive me operatorët turistikë për të mundur planifikim të përshtatshëm të burimeve; do të orientohet zhvillimi i destinacioneve kulturore dhe i instrumenteve të informimit për vizitorët, përfshirë sistemet digjitale dhe pikat e informacionit.

Qëllimi politik 2: përmirësimi i cilësisë, i standardeve dhe i ofrimit të shërbimeve vendore


Qëllimi i dytë i strategjisë synon që NJVV të ofrojnë shërbime eficiente për qytetarët, duke konsoliduar rolin e tyre të pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve të veta, bazuar në standarde të mirëpërcaktuara dhe duke rritur ndjeshëm performancën e tyre.

Strategjia synon adresimin e një sërë sfidash specifike mbi ushtrimin e funksioneve qofshin ato ligjore apo administrative. Përtej ecurisë së kënaqshme të harmonizimit ligjor pas RAT-it, ende mbeten disa paqartësi në ushtrimin e një pjese të funksioneve. Nga këndvështrimi administrativ, bashkitë ndeshen me sfidën e miradministrimit eficient të funksioneve, siç mund të përmendet shërbimi social, shërbimi i ujësjellës-kanalizimeve apo edhe i mbetjeve, për të cilin shtohet edhe kostoja e lartë e ofrimit të këtij shërbimi. Standardi i ofrimit të shërbimit lidhet drejtpërsëdrejti me cilësinë e shërbimit, i cili ka pasur diferenca ndërmjet bashkive. Që shërbimi të ofrohet në mënyrë të njëjtë te qytetarët, adresimi i kësaj sfide bëhet përparësi në këtë strategji.

Objektivat specifikë

Kjo strategji jep në mënyrë të përmbledhur aktivitetet dhe masat e parashikuara për secilin nga funksionet që ushtrohen nga qeverisja vendore. Kjo përfshin aspekte që lidhen me (mirë)zbatimin e tyre, por edhe aspekte ligjore për ta bërë ushtrimin e funksionit sa më eficient, të cilat përmbledhen në objektivat e mëposhtëm:

- objektivi specifik 2.1: konsolidimi i rolit të NJVV-ve në ushtrimin e funksioneve të tyre duke qartësuar mangësitë dhe mbivendosi ligjore e institucionale, dhe mekanizmat e financimit;
- objektivi specifik 2.2: zbatim i funksioneve të NJVV-ve;
- objektivi specifik 2.3: përmirësim i eficiencës së shërbimeve në përputhje me standardet kombëtare e vendore;
- objektivi specifik 2.4: nxitja përmbajtësore dhe financiare e forcimit të performancës së qeverisjes vendore.



Objektivi specifik 2.1: konsolidimi i rolit të NJVV-ve në ushtrimin e funksioneve të tyre duke qartësuar mangësitë dhe mbivendosjet ligjore, institucionale dhe mekanizmat e financimit në marrëdhëniet me qeverisjen qendrore.

Harmonizimi i ligjeve dhe i akteve nënligjore që saktësojnë marrëdhëniet midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore për forcimin e rolit të NJVV-ve në zbatimin e funksioneve.

Synimi i strategjisë është të propozojë masa konkrete sipas funksioneve për zgjidhjen e mbivendosjes së kompetencave që rezultojnë të jenë pengesa për zbatimin e funksioneve të veta. Bazuar në analizën e funksioneve të NJVV-ve, është evidente se një pjesë e funksioneve, pavarësisht se ligjërisht janë funksione të veta të NJVV-ve, në realitet kanë ende mbivendosje apo boshllëqe të paadresuara të kompetencave. Disa prej mbivendosjeve janë të identifikuara përgjatë viteve dhe janë ende të pazgjidhura, disa të tjera janë bërë evidente gjatë kësaj periudhe të zbatimit në praktikë të funksioneve të transferuara.

Nxitja e përgatitjes së udhëzuesve, rregulloreve, modeleve, planeve të përmirësimit të shërbimit që i shërbejnë organizimit të brendshëm të NJVV-ve për një ofrim sa më eficient shërbimi.

Në disa funksione, edhe kur nuk ka problematikë të evidentuar të marrëdhënies midis qeverisjes qendrore dhe qeverisë vendore, janë të nevojshme akte të vetë bashkive për të rregulluar administrimin dhe menaxhimin e funksionit. Strategjia do të propozojë kudo ku është e mundur masa që nxisin përdorimin e modeleve, të rregulloreve të shërbimit, të planeve të përmirësimit të shërbimit, analiza të proceseve dhe çdo masë tjetër të identifikuar si mjet për përmirësimin e ofrimit të shërbimit, për t'u hartuar dhe, aty ku ekzistojnë, për t'u shpërndarë dhe promovuar si mënyra për të forcuar menaxhimin e shërbimeve brenda vetë NJVV-ve.

Objektiv specifik 2.2: përmirësim i eficiencës së shërbimeve në përputhje me standardet kombëtare e vendore.

Furnizimi me ujë dhe largimi i ujërave të ndotura

Si pjesë e mbështetjes për përmirësimin e cilësisë, eficiencës dhe efektivitetit në sektorin e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve, do të ofrohet asistencë teknike për hartimin e planeve 5-vjeçare të biznesit për të gjitha ndërmarrjet rajonale UKN sh.a., në konsultim me NJVV-të. Po ashtu, në kuadër të reformës së rajonalizimit, bashkitë dhe sh.a.-të do të mbështeten për rishikimin e tarifave të ujit të përdorur. Në këtë fushë, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet nevojës për mbrojtjen e burimeve ujore të përcaktuara për ujin e pijshëm nëpërmjet përcaktimit të kriterëve dhe rregullimeve ligjore të posaçme.

Menaxhimi i arsimit parashkollor

Lidhur me arsimin parashkollor, kjo strategji synon të adresojë sfidat dhe paqartësitë në zbatimin e këtij funksioni, sfida të karakterit ligjor, financiar, administrativ dhe shoqëror. Strategjia propozon masa konkrete për qartësimin e mëtejshëm të rolit të bashkive në ofrimin e këtij shërbimi, përmirësimin e kapaciteteve vendore, përmirësimin e transfertave financiare dhe forcimin e pjesëmarrjes qytetare (nëpërmjet bordeve të prindërve) me synim final përmirësimin e cilësisë së shërbimit ofruar nga bashkitë, më konkretisht: i) rishikim i kuadrit ligjor dhe rregullator për të

vlerësuar nevojat për qartësime në përgjegjësitë e ndara mes nivelit qendror dhe vendor të qeverisjes ose përgjegjësi e drejtpërdrejtë e qeverisë qendrore dhe strukturave të saj të dekoncentuara në nivel vendor e rajonal, pa përfshirjen e bashkive; ii) aspekte financiare; për të vlerësuar mjaftueshmërinë e transfertës së pakushtëzuar sektoriale dhe kriteret e shpërndarjes së saj bazuar mbi numrin e nxënësve dhe mësuesve; iii) aspekte administrative të rritjes së kapaciteteve të administratës për të forcuar teknikat e menaxhimit dhe iv) aspekte shoqërore; për të rritur rëndësinë e këshillave të prindërve e bordeve të kopshteve dhe pjesëmarrjen e prindërve dhe aktorëve të tjerë në arsim.

Menaxhimi i mbetjeve

Përmirësimi i situatës së menaxhimit të mbetjeve përkon me një vullnet të fortë politik dhe angazhimin në një sërë investimesh të rëndësishme publike për kompletimin e ciklit të trajtimit në të gjithë territorin. Objektivat kryesorë në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë: i) Pozicionimi i NJVV-ve në administrimin e trajtimit të mbetjeve, në mënyrë që ky të mbetet një funksion qartazi vendor; ii) Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve në zona specifike si ato turistike; iii) Qartësimi i mekanizmave financiarë për mbështetjen e bashkive nga qeveria shqiptare për investimet, por edhe mbulimin tranzitor të kostove të larta të trajtimit të mbetjeve; iv) Fuqizimi i financave të veta vendore për mbulimin e kostove të shërbimit nëpërmjet tarifave; v) Ngritja e burimeve njerëzore në nivel teknik e menaxherial dhe monitorimi teknik e profesional i shërbimit dhe vi) Komunikimi transparent me qytetarët për të përmirësuar jo vetëm cilësinë e shërbimit dhe financimin e tij, por edhe forcimin e demokracisë vendore dhe rritjen e besimit në institucionet vendore.

Transporti publik vendor

Sfida kryesore gjatë kësaj periudhe të strategjisë është të rritet mbulimi dhe të përmirësohet ndjeshëm shërbimi i transportit publik vendor duke rritur financimin dhe standardet e shërbimit. Bashkitë do të kenë një qasje më gjithëpërfshirëse e të integruar ndaj mobilitetit në raport me atë tradicionale të transportit me automjete. Gjatë zbatimit të strategjisë do të punohet për harmonizimin dhe përafrimin e legjislacionit, do të ofrohet mbështetje për hartimin dhe zbatimin e projekteve për terminale multimodale të transportit publik dhe nxitës për lëvizshmërinë aktive edhe nëpërmjet mbështetjes së bashkëpunimi ndërvendor. Gjithashtu, do të ngrihet dhe operacionalizohet mekanizmi kombëtar për financimin e qëndrueshëm dhe një fondi kombëtar për subvencionimin e shtresave në nevojë dhe transportit të gjelbër.

Përfshirja sociale

Roli i bashkive mbetet thelbësor në planifikimin, buxhetimin e ofrimin e shërbimeve sociale. Strategjia parashikon masa që synojnë të përmirësojnë e qartësojnë marrëdhëniet mes niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe të nxisë njësitë e qeverisjes vendore për të rritur performancën në ofrimin e këtyre shërbimeve. Në kuadër të strategjisë, bashkitë do të akordojnë burime në rritje financiare dhe njerëzore dhe do të zhvillojnë përgjegjësitë e tyre duke filluar që nga vlerësimi i nevojave, planifikimi i buxheteve dhe kryerja e investimeve për të siguruar mbështetje për grupet në nevojë, ofrimin e shërbimeve sociale vendore dhe për të ngritur një sistem funksionues të identifikimit, vlerësimit, referimit dhe menaxhimit të rasteve. Në përputhje me Planin kombëtar të veprimit për PAK (PKVPAK), qeverisja vendore do të ndërmarrë investime për realizimin e aksesueshmërisë fizike; mjedise e transport të aksesueshëm, rritjen e kapaciteteve për dhënie e shërbimeve bazë për personat me aftësi të kufizuara. Strategjia e Mbrojtjes Sociale ka propozuar disa masa për të forcuar lidhjet ndërmjet shërbimeve sociale, programeve mbështetëse në para, si ndihma ekonomike dhe përfitimi i aftësisë së kufizuar, me riintegrimin social dhe punësimin. Zbatimi i këtyre masave thekson nevojën për koordinim më të mirë ndërsektorial. Gjithashtu, bashkitë do të intensifikojnë punën për identifikimin, mbledhjen e të dhënave për nevojat dhe programet e strehimit social dhe do të zbatojnë programet e strehimit social në bashkëpunim me organet e qendrore.

Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri

Në kuadër të funksionit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, kjo strategji adreson çështjet që kanë të bëjnë kryesisht me konsolidimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor, pamjaftueshmërinë e burimeve financiare, pajisjet e amortizuara, nevojën për ngritje të kapaciteteve tekniko-profesionale, hartimin e një modeli për kostimin e shërbimit, si dhe ngritjen e bazave të të dhënave për rrezikun nga zjarret dhe hartimin e dokumenteve të vlerësimit të rrezikut nga zjarret dhe gjithashtu të planeve të menaxhimit të zjarreve.

Mbrojtja civile

Sfidat kryesore që do të trajtojë kjo strategji në kuadrin e funksionit të mbrojtjes civile kanë të bëjnë kryesisht me konsolidimin e mëtejshëm dhe zbatimin sa më të mirë të kuadrit ligjor e nënligjor, ngritjen në nivel vendor të bazave të të dhënave për mbrojtjen civile; hartimin e vlerësimit vendor të riskut, hartimin e strategjive vendore për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive, si dhe të planeve vendore të emergjencave civile; forcimin e strukturave vendore me rritje të numrit të punonjësve; ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale, si dhe mbështetjen me investime për zhvillimin, modernizimin e aseteve, si dhe rehabilitimin e infrastrukturës së emergjencës civile.

Rendi dhe siguria publike

Në strategjinë e re adresohen çështje që kanë lidhje me plotësimin e bazës ligjore të funksionit të rendit dhe sigurisë publike, më konkretisht: miratimi i ligjit të ri për Policinë Bashkiake, hartimi i kuadrit nënligjor, hartimi i një standardi minimal dhe modeli kostimi për ofrimin e shërbimit të rendit dhe sigurisë nga forcat e policisë bashkiake, ngritja e kapaciteteve, shtimi i financimit për të mbështetur blerjen e pajisjeve dhe mjeteve moderne të nevojshme për ofrimin e shërbimit, si dhe nxjerrja e kuadrit rregullator për organizimin dhe funksionim e këshillave vendore të sigurisë publike.

Objektiv specifik 2.3: Përmirësim i eficiencës së shërbimeve në përputhje me standardet kombëtare e vendore

Hartëzimi i standardeve kombëtare

Strategjia propozon një hartëzim kombëtar të të gjitha standardeve minimale ekzistuese, identifikimin e boshllëqeve dhe propozimin e standardeve ku ato mungojnë, si dhe vendosjen në kuadrin ligjor të referencave të qarta për përdorimin e standardeve në kontekstin e politikave vendore. Ky aktivitet bazohet në gjetjet e ushtrimit të Ministrisë së Brendshme, në bashkëpunim me ministrinë e linjës, mbi hartëzimin e standardeve dhe është *input* thelbësor për ngritjen e sistemit të matjes së performancës.

Prioritizimi dhe vendosja e standardeve kombëtare minimale

Strategjia gjithashtu propozon edhe një studim më në thellësi të një grupi funksionesh të rëndësishme, ku t'u jepet përgjigje të gjitha çështjeve të diskutueshme, të identifikohet hendeku financiar (parashikuar në objektivin 4), të pilotohen zgjidhje dhe të përfitohen mësimet me vlerë për t'u shtrirë në vijim në fusha të tjera.³¹ Brenda tre viteve të para të strategjisë objektivi parashikon dakordësimin dhe formësimin ligjor të të paktën 30 (tridhjetë) standardeve minimale kombëtare për shërbime vendore.

Në kuadër të këtij objektivi parashikohet edhe kostimi i standardeve minimale kombëtare dhe atyre vendore, si një aktivitet i cili bazohet në një metodologji të qartë të përcaktimit të standardeve minimale, duke bërë të mundur edhe krahasimin midis bashkive. Kudo ku të jetë e mundur, studimet e propozuara do të marrin parasysh mundësinë e parashikimeve financiare për arritjen e këtyre standardeve. Në funksionet që do të studiohen më në detaj, përveç standardeve minimale kombëtare mund të përfshihen edhe metodologji ndihmëse për bashkitë, për të vendosur standarde vendore tek

³¹ Në këto funksione do të studiohet më në detaj ekzistenca e standardeve, propozimi për vendosjen e tyre në politikat kombëtare dhe / ose udhëzimi për standardet vendore të ofrimit të këtyre shërbimeve, si dhe skenarët e kostimit në varësi të nivelit të vetë standardeve.

ato bashki të cilat kanë ambicie për të vendosur standarde më të larta se niveli minimal ose për shërbime ku nuk është e mundur të ketë një standard minimal kombëtar.

Objektivi specifik 2.4: nxitja përmbajtësore dhe financiare e forcimit të performancës së qeverisjes vendore

Matja e performancës së NJVV-ve përbën një aspekt të rëndësishëm të agjendës së decentralizimit. Përcaktimi dhe matja e performancës nuk është thjesht një skemë monitorimi nga lart, por një mjet kyç që promovon në praktikë transparencën dhe llogaridhënien e institucionit të qeverisjes vendore ndaj qytetarëve, si dhe rrit kapacitetet e qeverisjes vendore dhe i mundëson asaj mekanizma për të vlerësuar, kontrolluar, motivuar dhe përmirësuar eficiencën dhe efektivitetin financiar, organizativ dhe vendimmarrës për një qeverisje të mirë.

Në këtë kontekst do të punohet për ndërtimin e një sistemi monitorimi të performancës, duke tejkaluar kontekstin aktual me një përvojë të pakonsoliduar dhe lidhjen e performancës me incentiva financiare, si një praktikë e suksesshme ndërkombëtare me një impakt të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve dhe performancës së qeverisjes vendore, si dhe për forcimin e marrëdhënieve midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore.

Krijimi i këtij instrumenti kërkon angazhim të një grupi pune të gjerë nga institucionet qendrore, qeveritë vendore dhe ekspertizë nga shoqëria civile dhe partnerë të zhvillimit, si dhe një konsultim të gjerë dhe konsensus në çdo etapë të tij. Objektivi është të ndërtohet një skemë operationale granti në periudhë afatmesme, duke pilotuar fusha e tregues kyç dhe gradualisht, të vlerësohet efektiviteti i grantit dhe shtrirja e tij në fusha të tjera, duke u bazuar në rezultatet dhe mësimet e nxjerra.

Sistemi i performancës do të ndërtohet mbi disa parime bazë, mes të tjerash:

- i. përfshirje treguesish financiarë, institucionalë, organizativë dhe funksionalë të qeverisjes.
- ii. përzgjedhje treguesish për të cilat qeveria vendore është drejtpërdrejt përgjegjëse dhe i ka në kontroll.
- iii. sistem i thjeshtë, funksional dhe i bazuar në të dhëna objektivist të verifikueshme dhe relativisht të lehta për t'u mbledhur nga qeveria vendore.
- iv. shfrytëzim i përvojës ekzistuese të matjes dhe raportimit të performancës, duke maksimizuar njohurinë ekzistuese në sistem.
- v. mbështetje në burimet njerëzore vendore me përgjegjësi të plotë dhe të trajnuara për këtë proces.

Skema e granteve bazuar në performancë do të bazohet, midis të tjerash, në këto parime:

- a) të jetë e qëndrueshme dhe e parashikueshme në periudhë afatmesme.
- b) fushat e matjes së performancës të jenë të përcaktuara qartë dhe kritere realiste, të thjeshta, transparente e të qarta për të gjithë.
- c) madhësia e grantit të jetë relative dhe tërheqëse për të nxitur pjesëmarrjen.

Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se qasja e granteve me bazë performancën është një nga instrumentet për të promovuar dhe përmirësuar funksionimin dhe efektivitetin e punës së qeverisjes vendore. Ky instrument duhet të mbështetet dhe koordinohet me masa të tjera, si reformat ligjore, fiskale dhe institucionale, kapacitetet dhe aftësitë teknike dhe profesionale të ekipit vendor, por dhe atij qendror në lidhje me hartimin, zbatimin, monitorimin dhe përmirësimin e skemës së treguesve dhe incentivave.

Në këtë kuadër bashkitë do të mbështeten për ngritjen dhe funksionimin e njësisve të performancës, përgjegjëse për implementimin e sistemit të performancës. Këto njësi duhet të mbledhin dhe të japin informacion për ofrimin e shërbimeve në nivel vendor dhe mirëqeverisje jo vetëm për vendimmarrje më eficiente menaxheriale të administratës, por edhe për të ushqyer debatin me këshillat bashkiakë, nivelin vendor e qendror dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje. Stabilizimi i kësaj strukture do të mbështetet nga AMVV me udhëzime orientuese dhe duke ofruar

asistencën e nevojshme nëpërmjet krijimit të një *help desk-u* pranë saj, të koordinuar ngushtësisht me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Shtetit për Standardet dhe Shoqatat Vendore.

Qëllimi politik 3: zgjerimi i qeverisjes digjitale në nivel vendor për të ofruar shërbime dhe programe qeveritare në mënyrë më eficiente, transparente dhe me kosto efektive

E-qeverisja është menduar si një mënyrë për të rritur efektivitetin administrativ, sikurse edhe sjell përfitime si promovimi i vlerave demokratike dhe përfshirja e qytetarëve³². Digjitalizimi i lejon qeveritë të veprojnë me transparencë dhe efikasitet më të madh. Në epokën digjitale, përdorimi i teknologjisë së informacionit ka potencial për të përmirësuar cilësinë e shërbimit publik, si në nivel qendror, ashtu edhe atë vendor.

Në dekadën e fundit, Shqipëria ka investuar gjithnjë e më shumë në krijimin e një strukture dhe kulture solide të qeverisjes elektronike, me implikime të drejtpërdrejta në transformimin e kanaleve të ofrimit të shërbimeve publike. Qeveritë kanë treguar një angazhim të palëkundur për të avancuar drejt shërbimeve *online*. Si rezultat, *e-qeverisja* është sot një realitet i prekshëm në Shqipëri. Portali i shërbimeve *online* (e-Albania) tani ofron deri në 1,227 shërbime publike *online* ose rreth 95% të gjithë shërbimeve publike të shtetit shqiptar, nga vetëm 14 shërbime të ofruara me fillimin e ndryshimit digjital rreth një dekadë më parë.

Pas shërbimeve elektronike të ofruara qëndron një arkitekturë komplekse, Platforma Qeveritare e Ndërveprimit, e cila është arkitektura bazë që mundëson ndërlidhjen e regjistrave elektronikë me njëri-tjetrin dhe shkëmbimin e të dhënave në kohë reale. Deri më sot janë 58 regjistra elektronikë, të cilët ndërveprojnë me njëri-tjetrin në kohë reale, duke bërë që mesatarisht 66% e formularit të aplikimit të plotësohet automatikisht në e-Albania, duke shkurtuar kohën e dhënies së shërbimit dhe duke thjeshtuar më tej procedurat. Teknologjia digjitale është një forcë themelore për ndryshimin në këtë shekull, duke riformuar ekonominë, qeverinë dhe shoqërinë civile – duke ndikuar kështu pothuajse në çdo aspekt të zhvillimit.

Në këtë kuadër që prej 1 janar 2020 qeveria qendrore ka shpallur vizionin e saj mbi transformimin rrënjësor digjital të shërbimeve, ku me impakt kryesor ishte vendimmarrja që kalonte barrën e mbledhjes së dokumenteve shtetërore që kërkohen për shërbimet tek administrata, duke lehtësuar qytetarët nga ecejaket nëpër institucione të ndryshme. Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE) është një tjetër lehtësi që shërben për të shkëmbyer elektronikisht të gjitha dokumentet shoqëruese shtetërore që lidhen me kërkesën për shërbim të një qytetari apo biznesi, duke i transmetuar ato me nënshkrim elektronik dhe duke siguruar gjithashtu gjurmueshmërinë të procesit të kërkesës për shërbim gjatë gjithë ciklit. Digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve përbën një mundësi të jashtëzakonshme për informimin e vendimmarrjes dhe monitorimin e performancës institucionale, eficiencën e proceseve dhe procedurave të dizenuara dhe riinxhinierimin e tyre.

Me rritjen e numrit dhe vëllimit të shërbimeve *online*, qeveria njoftoi mbylljen e zyrave të ofrimit të shërbimeve të qeverisë qendrore nga 1 maji 2022 dhe kalimin në modalitetin ekskluziv të ofrimit të shërbimeve *online*, me vetëm disa përjashtime, në të cilat prania fizike ishte e pashmangshme. Ndërsa ky ndryshim është mundësuar aktualisht nëpërmjet e-Albania si porta e centralizuar e qeverisë për ofrimin e shërbimeve publike të qeverisë qendrore për qytetarët dhe bizneset me akses 24/7, situata është e ndryshme për shërbimet publike të ofruara nga qeverisja vendore. Sot bashkitë operojnë me sisteme të ndryshme gjysmë të automatizuara për ofrimin e shërbimeve, të paktën katër lloje zyrash me një ndalesë që aksesohen fizikisht nga qytetarët dhe bizneset. Këto sisteme nuk kanë zëvendësuar plotësisht ofrimin e shërbimit manual konvencional dhe në përgjithësi janë pak ose aspak të integruara ose të lidhura me sistemet qeveritare dhe janë të cenueshme për sa i përket sigurisë së infrastrukturës së fortë/të butë. Ekzistojnë vetëm disa praktika të mira në këtë nivel, siç


³² <http://habibisir.lecture.ub.ac.id/files/2016/09/Defining-E-Governance.pdf>

është rasti i lejeve elektronike për ndërtime, të cilat janë funksionale që nga viti 2016 në të 61 bashkitë përmes një sistemi të qendëruar multifunksional të qeverisë qendrore.

Përparimi i nivelit qendror mund të jetë një levë dhe mundësi thelbësore për të filluar integrimin e nivelit të dytë të qeverisjes në reformat e përgjithshme të transformimit digjital. Zvogëlimi i diferencave digjitale midis dy niveleve të qeverisjes kërkon një qasje graduale që adreson sfidat e kapaciteteve ekzistuese njerëzore dhe infrastrukturore, ndërsa përparon në mënyrë graduale dhe të qëndrueshme në një fazë më të lartë të sistemeve, infrastrukturës dhe kapaciteteve për të shfrytëzuar inovacionet e mundshme duke mbajtur në vëmendje parësore përfituesin e shërbimeve dhe sigurimin e aksesit, në mënyrë që “askush të mos mbetet pas” (*leave no one behind*).

Objektivat specifike

Strategjia synon të adresojë nevojën për mbështetjen e proceseve të ndryshimit/inovacionit nëpërmjet rezultateve tashmë të arritura (ngritjen e një rrjeti prej 52 zyrave me një ndalesë bashkiake), shoqëruar me një njohuri të thellë të kontekstit përkatës në këtë fushë. Më konkretisht, synohet të forcohet efektiviteti dhe efikasiteti i qeverisjes vendore përmes konsolidimit të sistemeve, standardeve dhe kapaciteteve organizative në vend, zgjerimit dhe mbështetjes së inovacionit dhe praktikave më të mira të ofrimit të shërbimeve, nëpërmjet objektivave të mëposhtëm:



- Objektivi specifik 3.1: informimi i vendimmarrjes dhe i rrugëtimit të niveleve dhe aktorëve të përfshirë në Transformimin Digjital të Qeverisjes Vendore.

- Objektivi specifik 3.2: digitalizimi i ofrimit të shërbimeve vendore dhe integrimi në portalin e-Albania.

Objektivi specifik 3.1: informimi i vendimmarrjes dhe i rrugëtimit të niveleve dhe aktorëve të përfshirë në Transformimin Digjital të Qeverisjes Vendore

Reforma e transformimit digjital në nivel vendor do të bazohet thelbësisht në evidenca me qëllim që të adresojë sfidat dhe të kapitalizohet mbi mundësitë. Kjo reformë përfshin një numër të madh aktorësh dhe kërkon adresimin e sfidave të gjithë niveleve të qeverisjes dhe grupeve të ndryshme të interesit.

Në këtë kuadër, hartimi i një udhërrëfyese të bazuar në evidenca, i cili adreson sfidat dhe nevojat e qeverisjes, si edhe të qytetarëve, është i një rëndësie të lartë. Në veçanti, transformimi digjital përmirëson shpejtësinë, efektivitetin dhe lehtësinë e marrjes së shërbimeve administrative nga qytetarët.

Hartimi i udhërrëfyesis drejt përmbushjes së këtij vizioni planifikohet të vijë si rezultat i një set vlerësimesh të gatishmërisë digjitale që përfshin ekosistemin e përgjithshëm të vendit, gatishmërinë të qeverisjes vendore në nivel më të detajuar, si dhe gatishmërinë e qytetarëve. Gjetjet e këtyre vlerësimeve synojnë të ndihmojnë qeverinë qendrore dhe atë vendore me evidenca të sakta mbi nevojat dhe gatishmërinë digjitale të institucioneve vendore dhe të qytetarëve. Analiza të tilla ndihmojnë qeverisjen në evidentimin e pikave të forta dhe të dobëta për t'u adresuar në rrugëtimit drejt transformimit digjital.

Në këtë drejtim, vlerësimet e gatishmërisë digjitale shërbejnë që të:

- bëhet e matshme dhe kështu e diskutueshme në nivel lokal dhe kombëtar situata aktuale;
- identifikohen mangësitë dhe kufizimet e mundshme në politikëbërjen dhe zbatimin në nivel vendor;
- zbulohen nevojat për ngritjen e kapaciteteve midis të gjithë aktorëve dhe, nëse adresohen siç duhen, mund të kontribuojnë në një mjedis të favorshëm për reforma të suksesshme;
- forcohet aftësia për të dhënë përparësi, për të planifikuar, buxhetuar e monitoruar aktivitetet e ndërlydhura me ndërtimin e kapaciteteve;
- bëhet i zbatueshëm informimi i politikave të bazuara në evidenca për qeverisjen qendrore dhe vendore;
- forcohet angazhimi i shoqërisë civile dhe sektorit privat në qeverisjen vendore;
- vlerësohen, forcohen dhe zbatohen parimet e përfshirjes, të drejtat e njeriut dhe “askush të mos mbetet pas” (*leave no one behind*).

Objektivi specifik 3.2: Digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve vendore dhe integrimi në portalin e-Albania

Në vijim të përfundimit të analizës së gatishmërisë digjitale do të punohet paralelisht për identifikimin e listës së plotë të shërbimeve administrative dhe proceseve administrative që kryen secila NJVV në ofrimin e shërbimeve. Pas përfundimit të fazës së analizës për transformimin digjital të shërbimeve vendore, do të fillojë puna për digjitalizimin e ofrimit të shërbimeve online në portalin e-Albania, procedurave të brendshme të bashkive për trajtimin e aplikimeve dhe ofrimin e shërbimit përfundimtar vetëm elektronikisht, si dhe ngritjen e infrastrukturave përkatëse mbështetëse. Kjo do të nënkuptojë gjithashtu përdorimin dhe aplikimin e nënshkrimit dhe vulës elektronike, në procese të ndryshme të ofrimit të shërbimeve dhe digjitalizimin e procedurave të brendshme administrative.

Me qasjen online të shërbimeve, qytetarët dhe bizneset nuk do të kenë nevojë të paraqiten pranë bashkive për aplikime shkresore. Ofrimi online i shërbimeve vendore do të mundësojë qasje të pakufizuar dhe të barabartë të qytetarëve dhe bizneseve në orare, transparencë e përgjegjshmëri, duke ulur ndjeshëm kohën e ofrimit të shërbimeve dhe kohën e marrjes së tyre. Çdo aplikim për shërbim do të jetë i gjurmueshëm dhe tërësisht transparent. Përmes mekanizmave të monitorimit, do të reduktohen vonesat në ofrimin e shërbimeve. Në portalin e-Albania do të ofrohen shërbime që janë riinxhinierizuar 100%, duke ofruar një shërbim tërësisht elektronik.

Nga ana tjetër, digjitalizimi i procedurave të brendshme të bashkive do të ndihmojë në automatizimin e punës, duke sjellë rritjen e eficiencës dhe produktivitetit të punonjësve. Në tërësi, digjitalizimi do të ndikojë në rritjen e të qenit miqësor ndaj mjedisit, duke eliminuar dokumentet në letër përmes promovimit të dokumentit elektronik, si dhe duke reduktuar rrënjësisht lëvizjen e qytetarëve që udhëtojnë me mjete motorike drejt sporteleve fizike, një mënyrë për reduktimin e emetimit të ndotjes në ajër.

Ky proces do të shoqërohet me mbështetje të vazhdueshme ndaj NJVV-ve, me qëllim ofrimin sa më eficient të shërbimeve vendore nga ana e tyre në formë elektronike bazuar në procedura standarde të veprimit dhe udhëzime të ofrimit të shërbimit.

Qëllimi politik 4: rritja e autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta

Decentralizimi fiskal dhe financiar ka ecur me ritme të qëndrueshme në Shqipëri gjatë dekadave të fundit. Megjithatë përgjegjësitë në rritje të qeverisjes vendore diktojnë nevojën e rritjes së peshës së të ardhurave dhe shpenzimeve vendore ndaj PBB-së dhe shpenzimeve të qeverisjes së përgjithshme, në veçanti rritja e të ardhurave diskrecionare si transferta e pakushtëzuar, të ardhurat e veta dhe taksat e ndara. Strategjia parashikon masa për shpërndarjen më të drejtë vertikale (midis qeverisë qendrore dhe asaj vendore) dhe horizontale (midis njësive të ndryshme) të burimeve, duke u përqendruar jo vetëm në rritjen e autonomisë financiare por edhe rritjen e kapaciteteve vendore për të realizuar të ardhura dhe mekanizma ekualizues për trajtimin e pabarazive për shkak të kapitalit ekonomik apo natyror të njësive vendore. Së fundmi, rëndësia e një disiplinë të mirë fiskale dhe


instrumenteve eficente për menaxhimin e financave publike bëhet edhe më e rëndësishme më rritjen e rolit të NJVV-ve në ekonominë e vendit.

Nga ana tjetër, sfida mbi parashikueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e transfertës qeveritare dhe përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për financimin me transferata për funksionet vendore apo projektet kapitale në sektorë strategjikë për njësitë e vetëqeverisjes vendor mbetet për t'u adresuar.

Objektivat specifikë

Financat vendore mbetet një shtyllë e rëndësishme e agjendës së decentralizimit, duke krijuar mundësi që qeveritë vendore të kenë më shumë burime financiare, në mënyrë që ato të kryejnë funksionet dhe kompetencat e tyre në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet objektivave specifikë si më poshtë:

- objektivi specifik 4.1: rritja e kapacitetit të të ardhurave vendore me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimeve cilësore dhe me standarde;
- objektivi specifik 4.2: nivel i përmirësuar i parashikueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së transfertës qeveritare dhe përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për financimin me transferata për funksionet vendore apo projektet kapitale në sektorë strategjikë për NJVV-të;
- objektivi specifik 4.3: rritja e kapacitetit të burimeve financiare vendore me qëllim financimin e projekteve kapitale në nivel vendor;
- objektivi specifik 4.4: forcimi i sistemeve në nivel vendor të menaxhimit të financave publike dhe të informacionit financiar.



Objektivi specifik 4.1: rritja e kapacitetit të të ardhurave vendore me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimeve cilësore dhe me standarde

Rritja e kapaciteteve të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve, si edhe e autonomisë fiskale vendore është objektivi 4 i SNDQV-së. Synimi kryesor është rritja e nivelit të autonomisë financiare të qeverisjes vendore, veçanërisht duke rritur nivelet e financimit të funksioneve vendore. Rritja e autonomisë fiskale është parashikuar të arrihet nëpërmjet: i) rritjes së të ardhurave vendore nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme; ii) rritjes së pjesës së taksave të ndara; dhe iii) gjenerimit të të ardhurave nga aktiviteti ekonomik i njësitë të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet përdorimit më eficient të aseteve vendore.

Ky objektivi mund të synojë në një periudhë afatmesme që të arrihet niveli i të ardhurave totale vendore në përqindje të PBB-së i barabartë me mesataren e të ardhurave të vendeve të rajonit (rreth 5.2%). Ndërsa në një periudhë afatgjatë mund të synohet të arrihet mesatarja e vendeve të Bashkimit Evropian prej 10.6% e PBB-së. Realizimi i plotë i objektivave të strategjisë si ndërthurje e decentralizimit fiskal dhe funksional do të bëhet e shtrirë në kohë dhe duke përcaktuar qartë se çfarë mund dhe duhet të arrihet nga rritja e të ardhurave të veta dhe çfarë do të plotësohet nga rritja e

transfertës për qeverisjen vendore. Si pjesë e kësaj analize duhet të ndërmerret një studim i kostove për zbatimin e funksioneve të vetëqeverisjes vendore, për të bërë të mundur që burimet e disponueshme të përkojnë me përgjegjësitë e transferuara.

Rritja e të ardhurave vendore nga taksat mbi pasurinë e paluajtshme

Reforma do të ketë në themel një plan strategjik zbatimi, koordinim efektiv institucional dhe mbështetjen e vazhdueshme të *leadershipit*/drejtuesve politikë. Në vazhdimësi të hapave të ndërmarrë gjatë viteve të fundit, objektivi afatmesëm për të ardhurat nga taksat mbi pasurinë e paluajtshme është arritja e nivelit 0.5% të PBB-së, nga 0.3% e PBB-së që është aktualisht, nëpërmjet zgjerimit të bazës tatimore falë administrimit më të mirë fiskal.

Objektivi afatgjatë duhet të synojë rishikimin e taksimit mbi pronën dhe vlerësimin e përshtatshmërisë së nivelit aktual të tatimit, i cili mbetet i ulët krahasuar edhe me vendet e rajonit, si edhe i ulët në krahasim me koston administrative të mbledhjes së tij. Ndërsa aktualisht po punohet për taksimin e ndërtesave mbi bazën e vlerës së tregut, në planet e reformës është dhe taksimi i tokave mbi bazën e vlerës së tregut (kjo përkon me periudhën që mbulon kjo strategji). Po ashtu rritja e sipërfaqes së ndërtuar aktualisht, e reflektuar në rritjen e të ardhurave nga taksat e ndikimit në infrastrukturë, pritet të rezultojë në një rritje të bazës së taksueshme për taksën e pasurisë në vitet në vijim.

Objektivi afatgjatë synon reformimin tërësor të sistemit të taksimit të pasurive të paluajtshme në Shqipëri dhe përfshirjen e ndërhyrjeve përmirësuese në legjislacion, nivelin e politikave dhe atë të administrimit, për të mundur: i) taksimin e pasurive të paluajtshme, bazuar në vlerën e tregut, fillimisht për ndërtesat e më pas për tokën, në një nivel të përshtatshëm taksimi, të përafshuar me vendet e rajonit dhe me koston administrative më të ulët në krahasim me të hyrat, duke zbatuar njëkohësisht masa mbrojtëse për kategoritë në nevojë; dhe ii) një regjim tatimor më të drejtë, përmes zgjerimit të bazës tatimore si rezultat i shtimit të kategorive të pasurive të paluajtshme që taksohen, reduktimit të numrit të përjashtimeve ekzistuese dhe rritjes së numrit të pasurive të paluajtshme të regjistruara në kadastrën fiskale. Sipas parashikimeve të FMN-së, pas implementimit të reformës, të ardhurat e gjeneruara nga kjo taksë mund të arrijnë nivelet e 0.7% - 1% të PBB-së.³³

Së fundmi parashikohet zhvillimi i një sistemi monitorimi të mbledhjes së të ardhurave mbështetur në indikatorë sasiorë performance, që mund të japin të dhëna të besueshme për eficiencën në mbledhje. Performancat pozitive mund të lidhen me një skemë incentivuese granti (i dedikuar ose si kriter në formulën e transfertës së pakushtëzuar apo i skemave të tjera të granteve). Një mundësi për nxitjen e përmirësimit të administrimit të taksës së pasurisë është përllogaritja e ekualizimit fiskal për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar si funksion i kapacitetit fiskal nga taksat e pasurisë (në vend të të ardhurave të mbledhura).

Taksat e ndara

Strategjia do të vlerësojë mundësinë që njësitë të vetëqeverisjes vendore t'u ofrohet një mundësi për të rritur nivelin e burimeve financiare në dispozicion nga ndarja e taksave sipas përvojave të vendeve të tjera të rajonit dhe vendeve evropiane. Objektivi synon të arrihet një nivel i të ardhurave vendore nga taksat e ndara afërsisht në rreth 0.9% të PBB-së. Për këtë: i) do të konsolidohet metodologjia e ndarjes së taksës nga tatimi i të ardhurave personale; ii) do të shqyrtohet mundësia një forme ndarjeje për të ardhurat nga tatim fitimi dhe tatimi mbi vlerën e shtuar sipas përvojave të vendeve të tjera; dhe iii) do të rritet përqindja që shkon për qeverisjen vendore nga renta e shfrytëzimit të burimeve natyrore, në veçanti mineralet, duke konsideruar faktin se njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime dhe investime të nevojshme për shfrytëzimin e këtyre burimeve.

³³ John Norregaard, William McCluskey, and Lawrence Walters "Moving to a value based property tax. A roadmap for implementation.", IMF, 2014.

Të ardhura nga aktiviteti ekonomik i njërive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet përdorimit me eficiencë të aseteve vendore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund dhe duhet të nxiten për të shfrytëzuar avantazhet që rrjedhin nga burimet natyrore në territorin e tyre, nga pozicioni gjeografik, nga kërkesa për produkte apo shërbime etj. Financimi i këtyre aktiviteteve mund të bëhet nga të ardhurat e veta apo duke mundësuar huamarrjen për projekte ekonomike dhe financiare fitimprurëse. Këto politika duhet të shkojnë përtej krijimit të një mjedisi të përshtatshëm për biznesin dhe politikave fiskale vendore, duke u shtrirë edhe në bashkëpunimin financiar mes njërive të vetëqeverisjes vendore dhe financimin e projekteve të përbashkëta të zhvillimit.

Objektivi specifik 4.2: nivel i përmirësuar i parashikueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së transfertës qeveritare dhe përmirësimi i kuadrit ligjor e rregullator për financimin me transferata për funksionet vendore apo projektet kapitale në sektorë strategjikë për njësitë e vetëqeverisjes vendore

Si objektivi i strategjisë së re të decentralizimit këshillohet të bëhet vlerësimi i impaktit periodik të mekanizmave dhe efektivitetit të mekanizmave të ekualizimit fiskal vertikal dhe horizontal. Rishikimi i kriterëve ekualizues me faktorë të tjerë natyrorë, demografikë, ekonomikë duhet të synojë të rrisë kapacitetin financiar të njërive të vetëqeverisjes vendore me disavantazhe objektive për mobilizimin e të ardhurave të veta.

Transferata e granteve të përgjithshme dhe granteve sektoriale

Në stadin aktual, për shkak të shqetësimit që mund të ketë qeveria qendrore mbi rezultatin social, si dhe të administrimit të dobët financiar, forma më efikase e transfertës duhet të vazhdojë të jetë nëpërmjet granteve të dedikuara sektoriale (specifike). E rëndësishme është që NJVV-të të financohen gjithmonë me grante, minimalisht të barabarta me atë që qeveria qendrore kombëtare ka shpenzuar për to në kohën kur ky funksion menaxhohej nga vetë qeveria qendrore.

Rritja e transfertës së qeverisë qendrore në formën e granteve duhet të synojë:

- një objektivi afatmesëm mund të jetë arritja e një transfertë nga qeveria qendrore në një nivel 2.5% e PBB-së, në përafërsi me mesataren e vendeve të rajonit;
- rivlerësimin e kostove të funksioneve të përbashkëta, të cilat kanë kaluar plotësisht në përgjegjësinë e njërive të vetëqeverisjes vendore dhe plotësimin e financimit të këtyre shërbimeve;
- rritjen e granteve sektoriale në veçanti për shërbimet në sektorin social, të arsimit dhe të shëndetësisë.

Si objektivi afatgjatë, krahas përcaktimit të standardeve kombëtare minimale të shëndetit dhe sigurisë, për ofrimin e shërbimit dhe përlllogaritjes së kostos përkatëse të ofrimit të tyre në varësi të karakteristikave rajonale dhe ekonomike, strategjia synon rritjen e autonomisë financiare vendore nëpërmjet rritjes proporcionale të nivelit të transfertës së pakushtëzuar dhe uljes graduale të pjesës së transfertave të kushtëzuara për sektor. Kjo do të përmirësonte parashikueshmërinë e të ardhurave vendore, si dhe eficiencën në akordimin e burimeve midis sektorëve.

Objektivi specifik 4.3: Rritja e kapacitetit të burimeve financiare vendore me qëllim financimin e projekteve kapitale në nivel vendor

NJVV-të mund të rrisin kapacitetin e financimit të investimeve nëpërmjet dy mënyrave: i) financimit nga grantet e investimeve; dhe ii) financimit nëpërmjet huamarrjes. Në thelb transfertat e kushtëzuara për investime vendore duhet të jenë përjashtimi nga rregulli, për raste të veçanta që kërkojnë nivele të larta investimi apo ku qeverisja qendrore ka interesa të veçanta. Instrumente si FZHR-ja duhet të vazhdojnë të përdoren në të mirë të realizimit të përparësive vendore, por vendimmarrja vendore në realizimin e këtyre investimeve të jetë më gjithëpërfshirëse. Po ashtu mund të eksplorohej edhe skema të tjera financimi vendor, përfshirë fondet ripërtëritëse të investimit të (bashkë)menaxhuara nga bashkitë.

Financimi nëpërmjet huamarrjes të njërive të vetëqeverisjes vendore

Duke qenë se qeverisja vendore varet nga transfertat qeveritare, rregullat që përcaktojnë financat publike dhe huamarrjen duhet të jenë të qarta dhe të inkurajojnë qëndrueshmëri në huamarrjen vendore. Mundësimi i njëjësive të vetëqeverisjes vendore ndaj huamarrjes do të kërkojë vendosjen e një kufiri të nivelit të borxhit që mund të përdoret nga qeverisja vendore, brenda kufirit të lejuar të borxhit publik. Megjithatë ky objektiv mund të jetë i vështirë të arrihet në periudhë afatmesme, për shkak të niveleve relativisht të larta aktuale të borxhit publik.

Si përfundim: Shqipëria ka mundësi të rritjes së kapacitetit të të ardhurave vendore, si dhe të nivelit të transfertës për financimin e funksioneve vendore. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe forcimi i kapaciteteve të mbledhjes së të ardhurave vendore të njëjësive të vetëqeverisjes vendore mund të gjenerojë të ardhura shtesë në një vlerësim minimal në rreth 1.5 % të PPB-së dhe në një vlerësim relativisht më të lartë në 2.1% të PBB-së. Veç rritjes së të ardhurave të veta, transfertës së qeverisë qendrore, një burim tjetër i rritjes së të ardhurave mbetet gjenerimi i tyre nga aktiviteti ekonomik i drejtpërdrejtë i njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Ndërsa rritja e burimeve financiare për projekte investimesh përveç granteve të qeverisë qendrore mbetet i qenësishëm, një burim i konsiderueshëm dhe pothuajse i papërfillshëm mbetet rritja e huamarrjes për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Objekti i specifik 4.4: forcimi i sistemeve në nivel vendor të menaxhimit të financave publike dhe të informacionit financiar

Sistemi i Informacionit për Menaxhimin Financiar Vendor (SIMF-V)

Strategjia do të mbështesë ndërtimin e një Sistemi të Informacionit për Menaxhimin Financiar për qeverisjen vendore (SIMF), me synim konsolidimin e menaxhimit financiar dhe ofrimin e shërbimeve në qeverisjen vendore. SIMF-i vendor do të duhet të jetë i lidhur me Sistemin e Informacionit Financiar të Qeverisë së Shqipërisë (SIFQ), për të mundësuar vijueshmërinë për planifikimin dhe zbatimin dhe për të siguruar që informacioni për zbatimin e buxhetit nga SIFQ-i të përfshihet dhe të mbështesë planifikimet pasardhëse nëpërmjet SIMF-it vendor. Lidhje duhet të vendosen edhe me Sistemin e Informacionit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (IPSIS), Sistemin e Informacionit të Asistencës së Jashtme (EAMIS) dhe Sistemin e Informacionit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS). SIMF-i vendor do të konceptohet dhe ndërtohet në tri faza. *Faza 1* synon të vendosë një vizion për zgjidhjen e AFMIS-it vendor, të specifikojë kërkesat funksionale dhe të përcaktojë proceset kryesore të biznesit që duhet të mbështeten nga zgjidhjet informatike. Gjithashtu, ajo do të ofrojë një strukturë të specifikimeve për veprimtaritë dhe produktet e fazës së dytë, një vlerësim të kostos për fazën e dytë dhe një vlerësim të strukturës së kostove për veprimtaritë dhe produktet e fazës së tretë.

Faza e dytë do të përqendrohet në hartimin e një koncepti të detajuar për AFMIS-in vendor, për t'u siguruar që funksionalitetet e specifikuar gjatë fazës së parë të përfshihen qartë dhe në mënyrë të hollësishme për të udhëzuar ndërtimin e sistemit IT gjatë fazës së tretë.

Faza e parë do të përfundojë gjatë vitit 2022 dhe do të prodhojë termat e referencës për fazën e dytë. Prokurimi për fazën e dytë do të kryhet gjatë vitit 2023 dhe kjo fazë pritet të përmbyllet gjatë vitit 2024. Prokurimi për fazën e tretë do të parashikohet për fundin e vitit 2024/2025. Pritet që ndërtimi i sistemit IT për AFMIS-in vendor të fillojë gjatë vitit 2025.

Përmirësimi i proceseve të buxhetimit

Në funksion të reformimit dhe modernizimit të financave publike dhe kryesisht atyre vendore, gjatë vitit 2022 nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është vendosur që tri bashki të jenë në pilotim, për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Buxhetit Vjetor sipas riorganizimit të programeve buxhetore të orientuara nga buxhetimi në nivel produkti dhe kostimi i tyre, si dhe përgatitjes së buxhetit vendor me numër më të vogël se 20 programe që janë aktualisht.

Gjithashtu, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në periudhë afatmesme do të përfshijë edhe bashkitë e tjera sipas qasjes së bashkive që janë aktualisht në pilotim.

Gjithashtu, në këtë kuadër do të punohet për ristrukturimin e tabelës së konsoliduar të treguesve fiskalë për qeverisjen vendore, i cili konsiston në hartimin e një tablele të veçantë për treguesit fiskalë të qeverisjes vendore në mënyrë të pavarur nga treguesit fiskalë në nivel qendror, me qëllim monitorimin e vazhdueshëm të treguesve fiskalë të zbatimit të buxhetit vendor, në funksion të zbatimit të atyre politikave buxhetore që do të rrisin efikasitetin dhe efektshmërinë e përdorimit të fondeve publike në nivel vendor.

Konsolidimi i sistemit të kontabilitetit, i klasifikimit buxhetor dhe i raportimit financiar në funksion të përmirësimit të mbikëqyrjes të financave publike të NJVV-ve nga këshilli vendor

Për fazën tjetër të decentralizimit do të jetë e rëndësishme të vazhdojë fokusimi te përmirësimet e planifikimit buxhetor afatmesëm, raportimit dhe transparencës financiare dhe të performancës, si dhe llogaridhënies së njërive të vetëqeverisjes vendore. Konsolidimi i njërive të qeverisjes vendore në 61 bashki me 12 qarqet përkatëse ka përmirësuar ndjeshëm cilësinë e menaxhimit të financave publike në nivelin e qeverisjes vendore. Qasja më strategjike për planifikimin afatmesëm dhe zbatimin e buxhetit vendor duhet të plotësohet më tej me masa të tjera që mund përcaktohen si drejtime strategjike në strategjinë e re të decentralizimit. Këto do të kërkojnë përmirësime dhe rregullim të klasifikimeve buxhetore, planin e llogarive kontabël, të përgjegjësive të kontabilitetit për të ofruar raportim të harmonizuar të drejtuesit dhe këshilli vendor (këshilli i bashkisë ose i qarkut), për të mbikëqyrur realizimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomi të ofrimit të shërbimeve publike me cilësi të mirë për banorët që i zgjedhin këto organe.

Qeveria qendrore do të vazhdojë të luajë një funksion mbikëqyrës për financat publike të qeverisjes vendore, por gjithnjë e më shumë kjo duhet të bëhet përgjegjësi e këshillave të zgjedhur, të mbështetur edhe nga aktivitetet e auditimit të jashtëm, për të garantuar qëndrueshmërinë e financave të çdo bashkie dhe qarku. Funksioni mbikëqyrës i qeverisë qendrore përfshin monitorimin e rregullt brenda vitit dhe monitorimin në fund të vitit të performancës financiare të bashkive dhe qarqeve dhe vlerësimin e tij për shkallën në të cilën bashkitë përballen ose ka të ngjarë të përballen me vështirësi financiare tani dhe në të ardhmen. Për të siguruar qartësi në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit, do të duhet të bëhet punë e mëtejshme për të siguruar që klasifikimi buxhetor, plani kontabël dhe formatet e raportimit për njësitë e vetëqeverisjes vendore t'u ofrojnë kryetarëve të bashkive dhe ekipit të tyre informacionin e nevojshëm menaxherial dhe në të njëjtën kohë t'u sigurojë këshilltarëve informacionin që u nevojitet për të siguruar që NJVV-ja po arrin vlerën më të mirë për paranë në ofrimin e shërbimeve publike për banorët e saj.

Krijimi i nënllogarive individuale të NJVV-ve në llogarinë e vetme të Thesarit

Në funksion të transferimit të përgjegjësisë mbikëqyrëse, bashkitë dhe qarqet do të duhet të kenë një pamje dhe kontroll më të qartë mbi çështjet e tyre financiare. Për këtë qëllim qeveria qendrore duhet të lejojë njësitë e vetëqeverisjes vendore të kenë llogaritë e tyre të veçanta brenda llogarisë së vetme të thesarit në Bankën e Shqipërisë. Kjo do t'u mundësojë njërive të vetëqeverisjes vendore të kenë në çdo kohë pamje të qartë të likuiditeteve në dispozicion, si dhe mund të shmangë efektin e kufizimeve të vendosura nga qeveria qendrore mbi transaksionet financiare në faza të caktuara të ciklit buxhetor, çka mund të krijojë pamundësi shpenzimi dhe mbartjen e fondeve në vitet pasardhëse buxhetore. Krijimi i llogarive të tilla nuk është vetëm praktikë e mirë, por është edhe një element kritik i autonomisë kuptimplote fiskale për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Po ashtu, në momentin që për NJVV-të bëhet e mundur qasje më e gjerë në financimet e huaja dhe huamarrjen e jashtme e të brendshme për investime, nënllogaritë e veçanta të NJVV-ve në Llogarinë e Vetme të Thesarit do të jenë një kërkesë e domosdoshme për kontabilitet të qartë dhe transparencë të plotë fizike dhe jo thjesht një opsion.

Përmirësimi i kontabilitetit vendor ka përfitime jo vetëm për vendimet menaxheriale dhe mbikëqyrjen brenda NJVV-ve, por vlen edhe për qartësuar ndarjen e qartë të aktiviteteve të nënsektorit të qeverisjes qendrore nga ato të nënsektorit të qeverisjes vendore kur konsiderojnë menaxhimin e qeverisjes së përgjithshme si një e tërë. Kjo do të kërkojë disa ndryshime të vogla në përgatitjen dhe paraqitjen e dokumentacionit buxhetor dhe statistikave financiare të fund të vitit për nënsektorin e qeverisjes vendore, nënsektorin e qeverisjes qendrore dhe sektorin e qeverisjes së përgjithshme në tërësi. Këto do të jenë në përputhje me praktikat ekzistuese për raportimin ndërkombëtar mbi financat publike, duke përdorur sistemin e Statistikave Financiare Qeveritare (FMN), i cili është baza mbi të cilën punon Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Qëllimi politik 5: forcimi i demokracisë vendore dhe përparimi i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor

Qëllimi i pestë i strategjisë ka në fokus forcimin e demokracisë vendore dhe përparimin e agjendës së Integritetit Evropian në nivel vendor, me synim forcimin e mirëqeverisjes në nivel vendor, nxitjen e politikave kundër korrupsionit nëpërmjet konsolidimit të mëtejshëm të arritjeve mbi integritetin, si edhe forcimin e rolit të qeverisjes vendore në zbatimin e politikave dhe të *Acquis Communautaire*. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të administratës vendore për të dhënë shërbime më eficiente, me transparencë dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve, si edhe përmbushjen e rolit të qeverisjes vendore në përparimin e agjendës së integritetit evropian.

Pas RAT-it është plotësuar i gjithë kuadri procedural dhe rregullator mbi funksionimin e këshillave bashkiakë (rregullorja mbi organizimin dhe funksionimin e këshillit, kodi i etikës, rregullorja e konsultimit publik etj.), përfshirë dhe strukturat mbështetëse, siç janë sekretariatet e këshillave. Përtej progresit të bërë gjatë viteve të fundit, pavarësisht nga roli domethënës që i atribuohet këshillit bashkiak prej ligjit organik nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ka ende vend për përmirësim, duke qartësuar në mënyrë shteruese veprimtarinë e këshillit bashkiak në të tria dimensionet e punës së tij, atë si vendimmarrës, përfaqësues dhe mbikëqyrës. Një çështje tjetër gjerësisht e diskutuar është përfaqësimi i banorëve të njësisve administrative (NJA) dhe zonave rurale në këshillat bashkiakë, e cila është e nevojshme të adresohet ose nëpërmjet rishikimit të mënyrës së zgjedhjes së këshillave bashkiakë dhe strukturave komunitare, ose/dhe prezantimit/ rjetësimit/ përdorimit të instrumenteve për përfaqësim të NJA-ve dhe zonave rurale në Këshill Bashkiak.

Nga ana tjetër, ndryshimi i vazhdueshëm i *leadershipit*/drejtuesve vendorë (afërsisht 70% e këshilltarëve ndryshojnë nga zgjedhja në zgjedhje³⁴), sjell vështirësi në cilësinë e punës së këshillave vendorë dhe përpjekjeve për rritjen e kapaciteteve të tyre. Në këtë kontekst, edhe pjesëmarrja e grave në këshilla ka vend për përmirësim të vazhdueshëm, përtej ecurisë pozitive, duke arritur kuotën e përfaqësimit të tyre në lista prej 50%. Gjithashtu, qeverisja vendore ka nevojë të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme mekanizmat e përfshirjes së qytetarëve në proceset konsultuese në mënyrë sistematike dhe domethënëse. Veçanërisht forcimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel vendor është një sfidë për t’u adresuar në këtë strategji.

Një tjetër aspekt i qeverisjes vendore për t’u konsoliduar lidhet posaçërisht me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, kjo nëpërmjet përmirësimit të integritetit dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies. Sfidat reflektohen edhe nga perceptimet e qytetarëve të identifikuar nga Hartëzimi i Qeverisjes Vendore (më i fundit i vitit 2020), ku nivelet e perceptuara të transparencës dhe llogaridhënies kanë pasur përmirësim në bashkitë e vogla, por jo në bashkitë e mëdha³⁵. Rritja e transparencës në të gjitha proceset e qeverisjes vendore, shoqëruar me hartimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, është e nevojshme për t’u adresuar në vitet në vazhdim për qeverisjen vendore.

³⁴ Lista e trajnimeve të Këshilltarëve të rinj (1068 të trajnuar nga 1619 në total).

³⁵ Hartëzimi i Qeverisjes Vendore (2020), <https://www.undp.org/albania/publications/local-governance-mapping-albania-2020>


Lidhur me agjendën e Integritimit Evropian në nivel vendor, qeverisja vendore has një sërë sfidash. Përtej progresit, duke qenë se rreth 70% e legjislacionit të BE-së do të duhet të zbatohet në nivel vendor, agjendës së decentralizimit i lipset të adresojë nevojën për forcimin e kapaciteteve administrative vendore, me qëllim përmbushjen e rolit të bashkive në këtë kuadër. Kjo kërkon gjithashtu përmirësimin e bashkërendimit midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore në përmbushje të agjendës së përbashkët të integritimit evropian dhe forcim të kapaciteteve në përthithjen e sa më shumë fondeve të BE-së. Patjetër, përpjekjet për një qeverisje të mirë vendore në shërbim të komunitetit dhe për institucione vendore të konsoliduara janë dhe duhet të përbëjnë një proces afatgjatë në konsolidim dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Nga ana tjetër, fuqizimi i kapaciteteve të administratës vendore është një çështje konstante, e cila ka nevojë të adresohet jo vetëm në terma të një ekipi të kualifikuar, por edhe të motivuar. Forcimi i kapaciteteve për përthithjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga BE-ja është një sfidë e prekshme veçanërisht në bashkitë e vogla. Vështirësi në ekip dhe kapacitete (njohuri në shkrim projektsh, zbatim apo dhe njohuri e aftësi të tjera) janë të pranishme, çka vështirësohet edhe më shumë nga sistemi i pagave jokonkurrues e i kënaqshëm. Ndër të tjera, sistemi i pagave diferencon bashkitë sipas madhësisë së tyre, duke e bërë edhe më të vështirë për bashkitë e vogla procesin e përthithjes së ekipit të kualifikuar, ndryshe nga bashkitë e mëdha dhe deri diku edhe të mesme, të cilat kanë informacionin dhe aftësitë e nevojshme për të aplikuar dhe zbatuar projektet e financuara nga BE-ja.

Objektivat specifikë

Përmirësimi i Demokracisë Vendore është një përpjekje e vazhdueshme në kuadër të agjendës së decentralizimit, me fokus në forcimin e transparencës dhe të pjesëmarrjes së komuniteteve, biznesit dhe shoqërisë civile në vendimmarrjen publike në nivel vendor dhe përparimin e agjendës së Integritimit Evropian në nivel vendor. Me synim adresimin e sfidave të sipërcituara, kjo strategji propozon objektivat specifikë të mëposhtëm:

- objektivi specifik 5.1: forcimi i demokracisë vendore nëpërmjet sigurimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse të mirëqeverisjes në nivel vendor;
- objektivi specifik 5.2: nxitja e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor dhe konsolidimi i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin;
- objektivi specifik 5.3: përparimi i agjendës së integritimit evropian në nivel vendor.



Objektivi specifik 5.1: forcimi i demokracisë vendore nëpërmjet sigurimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse të mirëqeverisjes në nivel vendor.

Objektivi i parë lidhet me forcimin e demokracisë vendore nëpërmjet sigurimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse të mirëqeverisjes në nivelin vendor. Së pari, demokracia vendore do të përfitonte nga një përshkrim shterues i ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, për të qartësuar kompetencat e të gjithë organeve të qeverisjes vendore. Strategjia synon t’i kushtojë rëndësi përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, në kuadër të proceseve konsultuese të këshillit në

përgjithësi apo dhe të vetë administratës vendore, duke e konsideruar përfshirjen e qytetarëve si një proces sistematik, domethënës dhe të buxhetuar. Çdo ndërhyrje për të konsoliduar e harmonizuar kuadrin ligjor, si dhe për të mbështetur këshillat bashkiakë në rritje kapacitetesh, në ndërtim e konsolidim të strukturave respektive administrative e menaxheriale, do të forconte demokracinë vendore duke intensifikuar ndërveprimin me institucionet në nivel qendror, rajonal e vendor, me qytetarët, strukturat komunitare dhe shoqërinë civile.

Këshillat bashkiakë kanë nevojë të njohin më mirë jo vetëm punën e administratës, por dhe atë të institucioneve të tjera (p.sh. degë territoriale), mbi punën dhe performancën e të cilave duhet të japin gjykim, vlerësim dhe të ndërveprojnë. Këshillat dhe këshilltarët më të mirë janë ata që punojnë ngushtë me qytetarët dhe komunitetet. Në këtë frymë strategjia synon të nxisë bashkëpunim me qëllim që qytetarëve t'u jepet më shumë vendimmarrje mbi komunitetin e tyre, të konsultohen dhe të përfshihen në vendimmarrje dhe aktivitetet e këshillit, të informohen dhe të vazhdojnë të ndikojnë për rritjen e cilësinë e shërbimeve në zonën e tyre.

Në kuadër të këtij objekti, synohet që NJVV-të të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë autonome duke respektuar kuadrin ligjor, mbështetur në parimin e subsidiaritetit duke ofruar shërbime efikase dhe eficiente në komunikim të vazhdueshëm dhe transparent me qytetarët. Në mënyrë të detajuar, ky objektivi specifik përshin aktivitetet e mëposhtme:

Konsolidim të rolit të NJVV-ve në ushtrimin e funksioneve të tyre duke qartësuar mbivendosjet ligjore dhe administrative në marrëdhëniet qeveritare

Strategjia synon konsolidimin e rolit të NJVV-ve në ushtrimin e funksioneve të tyre, me qëllim sigurimin e përfaqësimit, udhëheqjes, planifikimit dhe vendimmarrjes demokratike e efektive. Kjo nënkupton qartësim të kompetencave të organeve të qeverisjes vendore, duke ndarë qartë detyrat e organeve të qeverisjes vendore, si Këshilli Bashkiak si organ përfaqësues, mbikëqyrës dhe vendimmarrës dhe Kryetarit të Bashkisë si organ ekzekutiv. Kjo gjë do të garantojë adresimin e mbivendosjeve apo boshllëqeve ligjore; duke synuar kështu forcimin e demokracisë vendore dhe garantimin e llogaridhënies dhe të balancimit të pushteteve.

Gjithashtu, në kuadër të ndryshimeve/përmirësimeve ligjore, do të shihet mundësia e adresimit në përfaqësim më të "gjerë" gjeografik të anëtarëve të këshillit bashkiak, si edhe adresim të çështjeve të lidhura me kuadrin ligjor për konsultimin publik dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrjen vendore. Kjo do të mundësonte, përveç përmirësimeve ligjore, edhe përdorimin e mekanizmave të tjerë që mundësojnë në mënyrë demokratike dhe transparente (duke përfshirë platforma elektronike) përfshirjen sistematike të komunitetit në veprimtarinë dhe në vendimmarrjen e këshillit bashkiak, si dhe në monitorimin e zbatimit të politikave vendore. Në fokus do të jenë edhe strukturat komunitare të zgjedhura në mënyrë demokratike, efikase dhe të informuara lidhur me rolin e tyre në bashkëpunim me organet e zgjedhura dhe ekzekutive.

Ndërtim të një mekanizmi nxitës për një Këshill Vendor efikas

Duke konsoliduar rolin e këshillave bashkiakë synohet paralelisht ndërtimi i një mekanizmi nxitës për këshillat vendorë të bashkive, duke përfshirë aspekte si: performanca e këshillit, aspekti i tij financiar, si dhe nxitja e krijimi i modeleve dhe praktikave të mira të NJVV-ve. Strategjia parashikon këtu edhe forcimin e rolit të komisioneve bashkiake, si organe të rëndësishme në veprimtarinë e tij ligjëbërëse dhe monitoruese. Çdo nismë për garantimin e barazisë gjinore, veçanërisht në kuadër të komisioneve bashkiake, konsiderohet si një aspekt pozitiv jo vetëm i agjendës së decentralizimit, por edhe i agjendës së barazisë gjinore.

Në kuadër të modeleve të mira, strategjia synon të zhvillojë një platformë të rrjetëzimit/shkëmbimit të përvojave ndërmjet këshilltarëve në Shqipëri dhe me organizatat rajonale që përfaqësojnë dhe mbështesin këshilltarët.

Objektivi specifik 5.2: nxitja e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor dhe konsolidimi i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin

Integriteti, transparenca dhe llogaridhënia janë tri nga elementet kyç gjithëpërfshirës të nevojshëm për parandalimin efikas të korrupsionit në institucionet publike³⁶: Kur aktorët kryesorë publikë në nivel vendor sillen me ndershmëri dhe i përmbushin mandatet e tyre në përputhje me normat etike dhe morale, nuk mbetet hapësirë për korrupsion. Konsolidimi dhe përdorimi në rritje i këtij instrumenti nga më shumë se gjysma e bashkive në Shqipëri, si dhe kthimi i planeve të integritetit në standard dhe pjesë përbërëse të menaxhimit të përgjithshëm të administratave vendore është synimi i kësaj strategjie në kuadër të këtij qëllimi.

Në këtë kuadër, kjo përfshin forcimin e imazhit të zyrtarit publik në nivel vendor, bazuar te transparenca dhe përgjegjshmëria, rritjen e përfshirjes së shoqërisë civile në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e nismave të ndryshme me interes dhe ndjeshmëri lokale dhe rritjen e adoptimit të sistemeve që dekurajojnë praktikat korruptive dhe nxisin transparencën (lehtësimi i procedurave të ofrimit të shërbimeve, bërja publike e dokumenteve, konsultimi i politikave dhe përparësitë e zhvillimit, përmirësimi financiar dhe krijimi i ofrimit të shërbimeve dhe i mekanizmave të monitorimit).

Miratimi i instrumenteve të integritetit nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore do të krijojë një mjedis favorizues dhe do të përbëjë kushtet për një sistem të monitorimit të integritetit në dobi si të qeverisë qendrore, ashtu dhe asaj vendore. Krahas përpjekjeve të tjera dhe asistencës në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel bashkie, investimi në ngritjen e kapaciteteve do të kontribuojë në frenimin e korrupsionit dhe, për rrjedhojë, në harmonizimin me kërkesat e strategjive kombëtare të reformës kundër korrupsionit dhe asaj në administratën publike.

Strategjia propozon në kuadër të nxitjes së politikave kundër korrupsionit në nivel vendor:

Finalizimi i procesit të hartimit të planeve vendore të integritetit dhe Kodit të Sjelljes

Ky aktivitet përfshin hartimin e planeve vendore të integritetit dhe miratimin e tyre pranë këshillave bashkiakë në të gjitha bashkitë e mbetura/të tjera sipas fazave (faza I – 16 bashki miratojnë Plane Lokale të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes, faza II – 24 bashki, duke përfunduar kështu edhe hartimin e miratimin e të gjithë planeve të integritetit në nivel vendor). Të dyja fazat janë pjesë e planit afatshkurtër të veprimit të kësaj strategjie, konkretisht 2023–2025. Hartimi i planeve të integritetit do të bazohet në metodologjinë e miratuar nga Ministria e Drejtësisë, me të cilën janë hartuar 21 planet ekzistuese të integritetit.

Krijimi i mekanizmit të brendshëm institucional të strukturave qendrore për monitorimin e demokracisë dhe transparencës vendore

Në kuadër të konsolidimit të masave kundër korrupsionit dhe forcimit të demokracisë vendore synohet krijimi i një mekanizmi të brendshëm institucional me qëllim monitorimin dhe eventualisht kalibrimin sipas kontekstit të demokracisë vendore dhe mirëqeverisjes. Në këtë rast Ministria e Brendshme dhe AMVV-ja kanë rol kyç për të monitoruar produkte të lidhura me këtë fushë, për shembull planet e integritetit, programin e transparencës etj. Ndaj është i nevojshëm krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm, jo *ad-hoc*, për monitorimin e elementeve të demokracisë vendore dhe luftës kundër korrupsionit, ku është i mundur duke konsideruar edhe integrimin e elementit gjinor dhe jo diskriminimin. Kjo kërkon së pari evidentimin e këtyre elementeve, në koordinim edhe me institucione qendrore, vendore apo edhe partnerë zhvillimi (p.sh. Komisioni për të Drejtën e Informimit).

Objektivi specifik 5.3: Përparim i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor

³⁶ Integriteti i qeverisjes vendore: Principles and Standards - Nuno Ferreira da Cruz, Michel Gary - Transparency International © 2015 - ISBN: 978-3-943497-75-5.

Integrimi në BE është një proces sfidues që kërkon shumë përpjekje të administratës qendrore dhe vendore. Krijimi i një administrate publike joburokratike, profesionale dhe transparente, e aftë për të përballuar sfidat që sjell integrimi në BE dhe përthithja e fondeve të BE-së është një nga synimet kryesore në përparimin e reformës së administratës publike në nivel vendor.

Roli i qeverisjes vendore në zbatimin e politikave, zbatimin e *Acquis Communautaire* dhe agjendën e përgjithshme të integritimit evropian është shumë i rëndësishëm. Komisioni Evropian e thekson këtë rol në Komunikatën e 2019-s mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së: “Roli i autoriteteve rajonale dhe lokale në procesin e harmonizimit të BE-së dhe zbatimi eventual i rregullave të BE-së duhet të merret parasysh. Duhet të gjendet një ekuilibër i përshtatshëm ndërmjet qeverisjes qendrore, rajonale dhe vendore që të mbështesë më së miri zbatimin e reformave dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët.”³⁷

